BULETINI PERIODIK

MAJ-KORRIK 2026

www. gjykatakushtetuese.gov.al

Buletini periodik i vendimmarrjes
Nr. 3, Maj - Korrik 2026
© Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë

HYRJE

Në kuadër të komunikimit të vazhdueshëm me publikun dhe median, të garantimit të transparencës, si dhe të rritjes së aksesit në Gjykatën Kushtetuese, si një nga parimet më të rëndësishme dhe thelbësore të administrimit të drejtësisë, Gjykata publikon Buletinin Periodik të vendimmarrjes së saj. Ai ka si qëllim informimin dhe njohjen e praktikantëve të së drejtës, studiuesve të ligjit, e çdo lexuesi, me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, dhe me qëndrimet e mbajtura prej saj. Kështu, botimi i sjell vendimet në mënyrë të përmbledhur dhe me një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për lexuesin. Për secilën prej tyre, paraqiten Faktet që lidhen me çështjen konkrete, vlerësimi i Gjykatës lidhur me pretendimet e kërkuesit, ashtu edhe vendimmarrja e mënyra e votimit.

Në këtë numër do të gjeni të gjitha vendimet përfundimtare të dhëna gjatë periudhës maj – korrik 2026.

PËRMBAJTJA

Konflikt kompetence.....3

Kontroll incidental.....6

Ankim kushtetues individual.....9

E drejta e pakicës parlamentare për të kërkuar ngritjen e komisioneve hetimore

FJALË KYÇE

Komision hetimor/ Pakica parlamentare/ Kontroll parlamentar/ Çështje e veçantë/ Interes publik/ Vullneti i shumicës parlamentare/ Procesi zgjedhor/ Fshehje e të ardhurave/ Autoritetet e huaja/ Ish agjent i FBI-së/ Zgjedhje parlamentare/ Ligjshmëri e veprimeve të organeve shtetërore/ Mosmarrëveshje kompetencash

Kërkesa kushtetuese për përcaktimin e qartë të objektit të hetimit nuk mund të interpretohet në kuptimin se pakica parlamentare duhet të paraqesë prova të plota ose të vërtetojë paraprakisht faktet që synon të hetojë komisioni. Për ngritjen e komisionit hetimor mjafton që objekti të jetë i përcaktuar qartë dhe të mbështetet në indicie të arsyeshme që justifikojnë ushtrimin e kontrollit parlamentar.

Një grup prej 38 deputetësh (jo më pak se një e katërta) të Kuvendit të Shqipërisë

Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pakicës parlamentare dhe Kuvendit për shkak të mosmiratimit nga Kuvendi të ngritjes së dy komisioneve hetimore

Vendim nr. 62, datë 01.06.2026

Faktet

Kërkuesit depozituan në Kuvend, dy kërkesa për ngritjen e dy komisioneve hetimore: i) njëri për verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve të zyrtarëve shqiptarë në raport me ish-agjentin special të FBI-së të SHBA-së (*Komisioni i Parë*); ii) tjetri për verifikimin e ligjshmërisë së veprimtarisë të organeve të pushtetit qendror dhe pushtetit vendor, si dhe përdorimit të burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 11 majit 2025, si dhe vlerësimin e nevojës për marrjen e masave, përfshirë ndërhyrjet ligjore për garantimin e parimeve të ligjshmërisë, integritetit, barazisë, lirisë dhe ndershmërisë në proceset zgjedhore të ardhshme (*Komisioni i Dytë*). Me vendimet nr. 77/2025 dhe nr. 78/2025, Kuvendi vendosi mosmiratimin e ngritjes së këtyre komisioneve hetimore parlamentare. Në vijim, kërkuesit, një grup prej 38 deputetësh të Kuvendit, iu drejtuan Gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës midis tyre dhe Kuvendit, si dhe deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 77/2025 dhe nr. 78/2025 të Kuvendit.

Vlerësimi i Gjykatës

Për themelin e kërkesës – Gjykata, në rastin konkret, vlerësoi nëse refuzimi i ngritjes së këtyre komisioneve është bërë në përputhje me kriteret dhe standardet kushtetuese në ushtrimin e së drejtës së pakicës parlamentare sipas nenit 77, pika 2, të Kushtetutës.

Për kërkesën për ngritjen e Komisionit të Parë – Gjykata, në përfundim të diskutimeve, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, për rrjedhojë, në zbatim të nenit 73, pika 4, të ligjit organik të gjykatës, kërkimi u konsiderua i rrëzuar.

Sipas njërit qëndrim, kërkesa për ngritjen e komisionit hetimor nuk përmbush kriterin kushtetues të një "çështjeje të veçantë", pasi objekti i propozuar nuk individualizon me qartësi faktet ose grupin e fakteve që do t'i nënshtroheshin hetimit parlamentar.

Sipas qëndrimit tjetër, kërkesa plotëson kriterin kushtetues "çështje e veçantë", megjithatë, përmbushja e këtij kushti të domosdoshëm nuk është gjithmonë e mjaftueshme për aktivizimin e urdhërimit të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës.

Sipas një tjetër qëndrimi, qëllimi i ngritjes së komisionit ishte ushtrimi i kontrollit politik parlamentar dhe evidentimi i përgjegjësisë politike të zyrtarëve të lartë të pushtetit ekzekutiv për veprimet ose mosveprimet e tyre në ushtrimin e funksioneve publike, pa synuar përcaktimin e përgjegjësisë penale. Objekti i hetimit ishte përcaktuar qartë dhe lidhej drejtpërdrejt me funksionet kushtetuese të Kuvendit dhe çështja paraqiste një karakter të veçantë, pasi kërkesa mbështetej në një grup faktesh konkrete që u atribuoheshin zyrtarëve shqiptarë dhe që ngrinin dyshime të arsyeshme për ligjshmërinë e veprimtarisë së tyre.

Për kërkesën për ngritjen e Komisionit të Dytë – Gjykata analizoi në raport me pretendimet e kërkuesit, nëse objekti i hetimit është përcaktuar qartë, lidhet me funksionet kushtetuese të Kuvendit, si dhe nëse qëllimi i tij respekton kufijtë kushtetues të këtij instrumenti të kontrollit parlamentar.

(vijon në faqen 4)

KONFLIKT KOMPETENCE

Kërkimi që faktet të provoheshin plotësisht që në fazën e paraqitjes së kërkesës do të vendoste mbi pakicën parlamentare një barrë joproporcionale, duke e bërë praktikisht të pamundur ngritjen e një komisioni hetimor dhe duke cenuar garancinë kushtetuese të parashikuar në nenin 77 të Kushtetutës .

Fakti që Kuvendi ka vendosur të ngrejë një komision për reformën zgjedhore nuk mund të përbëjë shkak kushtetues për t'i mohuar pakicës parlamentare të drejtën për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor, për sa kohë që ky i fundit përmbush kriteret e parashikuara nga neni 77 i Kushtetutës.

Në vlerësimin e saj hetimi parlamentar nuk synon të përcaktojë përgjegjësi penale individuale, të ndërhyjë në kompetencat e organeve të drejtësisë ose të organeve të administrimit dhe gjykimit të mosmarrëveshjeve zgjedhore, por të ushtrojë funksionin kushtetues të kontrollit parlamentar mbi veprimtarinë e autoriteteve publike dhe të krijojë bazën e nevojshme për ushtrimin e funksionit ligjvënës. Gjithashtu, çështja përbën një "çështje të veçantë", në kuptim të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës. Integriteti i procesit zgjedhor, respektimi i parimeve të zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe përdorimi i burimeve publike gjatë zgjedhjeve janë çështje që lidhen drejtpërdrejt me funksionimin e rendit demokratik dhe paraqesin një interes të veçantë publik. Sa i takon objektit të këtij komisioni, fakti që disa aspekte të procesit zgjedhor mund të kenë qenë objekt shqyrtimi nga organet e administrimit ose gjykimit zgjedhor nuk përjashton ushtrimin e funksionit kushtetues të kontrollit parlamentar, për sa kohë që komisioni nuk ndërhyn në kompetencat e tyre dhe nuk synon të rishqyrtojë ose të zëvendësojë vendimmarrjen e tyre. Për rrjedhojë, Gjykata gjeti të bazuar kërkimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar nga vendimi nr. 78/2025 i Kuvendit dhe shfuqizimin e atij vendimi.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e pjesshëm të kërkesës (tre gjyqtarë u shprehën me mendim paralel).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE

Kriteret e legjitimimit për vënien në lëvizje të gjykimit incidental nga gjykatat e zakonshme - E drejta për zhdëmtim të drejtë

FJALË KYÇE

Vjedhje në bashkëpunim/Arresti në burg/Pafajësi/Kompensim i burgimit të padrejtë/Gjykata referuese/ Pezullim gjykimi

Neni 44 i Kushtetutës nuk garanton një shumë të caktuar kompensimi, por të drejtën për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim në përputhje me ligjin. Në këtë kuptim, ligjvënësi gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi për të përcaktuar kushtet, kriteret, procedurat dhe masën e kompensimit. Ky diskrecion, megjithatë, nuk është i pakufizuar.

Rregullimi ligjor duhet të respektojë thelbin e garancisë kushtetuese, të mbështetet në kritere objektive dhe të arsyeshme, të jetë proporcional me qëllimin e synuar dhe të mos e bëjë të drejtën për zhdëmtim iluzore ose joefektive.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Lushnjë

Kompensimi për burgim të padrejtë

Vendimi nr. 70, datë 08.06.2026

Faktet

Në datë 30.03.2018, Gjykata e Beratit caktoi masën e sigurimit të arrestit në burg ndaj dy shtetasve të dyshuar për vjedhje në bashkëpunim. Në përfundim të gjykimit, njëri prej tyre u shpall i pafajshëm, ndërsa tjetri fajtor dhe u dënua me 8 muaj burgim. Të dy u liruan më datë 13.12.2018.

Në prill të vitit 2025, të dy shtetasit paraqitën padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Lushnjë (gjykata referuese), njëri për kompensimin e paraburgimit të padrejtë prej 8 muajsh e 15 ditësh në shumën 1.164.000 lekë, ndërsa tjetri, për periudhën që tejkalonte me 3 muaj e 5 ditë masën e dënimit, në shumën 450.000 lekë.

Gjykata referuese konstatoi se, dispozitat e ligjit për kompensimin e burgimit të padrejtë të cilat vendosin një kufi maksimal për masën e dëmshpërblimit deri në vlerën 2.000 (dy mijë) lekë për një ditë burgim, 3.000 (tre mijë) lekë për një ditë paraburgim dhe 1.000 (një mijë) lekë për një ditë nën masën e arrestit në shtëpi, binin ndesh me nenin 44 të Kushtetutës dhe nenin 5, pika 5 të KEDNJ-së, ndaj pezulloi gjykimin dhe iu drejtua Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e këtyre parashikimeve ligjore.

Vlerësimi i Gjykatës

Për legjitimimin e gjykatës referuese - Gjykata çmoi se gjykata referuese legjitimohet të kërkojë kontrollin kushtetues vetëm për togfjalëshin "3.000 (tre mijë) lekë për një ditë paraburgim", ndërsa për pjesën tjetër të dispozitave të kundërshtuara nuk legjitimohet, pasi ato nuk gjejnë zbatim në mosmarrëveshjen konkrete. Ajo ka parashtruar argumente konkrete, sipas të cilave vlera financiare cenon të drejtën për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim nga paraburgimi i padrejtë, për shkak se masa e kompensimit është në një nivel aq të ulët sa nuk siguron një kompensim efektiv për dëmin e shkaktuar dhe ka arritur, në mënyrë të arsyetuar, në përfundimin se kontrolli incidental përbënte mjetin e fundit për zgjidhjen e çështjes në përputhje me Kushtetutën.

Për themelin e pretendimit për cenimin e së drejtës për zhdëmtim të drejtë - Gjykata çmoi të analizojë nëse rregullimi ligjor i kundërshtuar, në rrethanat konkrete të çështjes, ruan një ekuilibër të drejtë ndërmjet hapësirës së vlerësimit të ligjvënësit dhe thelbit të së drejtës kushtetuese për zhdëmtim, pra nëse mekanizmi i kompensimit vazhdon të sigurojë një zhdëmtim real dhe proporcional për dëmin e shkaktuar nga kufizimi i padrejtë i lirisë. Gjykata konstatoi se brenda hapësirës së vlerësimit që i njeh Kushtetuta, ligjvënësi ka zgjedhur një model të standardizuar kompensimi, i cili synon të garantojë një zhdëmtim real, efektiv dhe proporcional me cenimin e pësuar, duke mbajtur njëkohësisht në konsideratë interesin publik dhe mundësitë financiare të shtetit. Shuma prej 3.000 (tre mijë) lekësh nuk përbën një shumë fikse kompensimi, por kufirin maksimal që mund të caktohet nga gjykata.

(vijon në faqen 7)

Proporcionaliteti i masës së kompensimit duhet të vlerësohet në raport me realitetin ekonomik të periudhës kur ka lindur e drejta për kompensim, i cili nuk synon të zëvendësojë të ardhurat individuale të personit të dëmtuar, por të garantojë një zhdëmtim të standardizuar dhe proporcional për cenimin e lirisë personale.

Si rregull, kur ligji parashikon të drejta ose detyrime të shprehura në shuma monetare fikse, me qëllim ruajtjen e efektivitetit të të drejtave themelore, ligjvënësi duhet të vlerësojë periodikisht nevojën për rishikimin e tyre, në mënyrë që ato të pasqyrojnë zhvillimet ekonomike të vendit, përfshirë inflacionin, fuqinë blerëse të monedhës dhe tregues të tjerë ekonomikë relevantë. Një rishikim i tillë kontribuon në ruajtjen e efektivitetit të rregullimeve ligjore dhe në realizimin e qëllimit për të cilin ato janë miratuar.

Ligji parashikon një mekanizëm që lejon individualizimin e masës së kompensimit në varësi të rrethanave konkrete të secilit rast, me synimin për të mbuluar dëmin e shkaktuar nga kufizimi i padrejtë i lirisë. Në këtë proces, barra e provës për rrethanat që justifikojnë masën e kompensimit i takon kërkuesit.

Fakti që dispozitat ligjore për kompensimin nuk kanë pësuar ndryshime që nga miratimi i tyre nuk mjafton, në vetvete, për të arritur në përfundimin se ato bien ndesh me Kushtetutën. Në rastin konkret, treguesit ekonomikë të vitit 2018 nuk rezultojnë të kenë pësuar ndryshime të tilla, në raport me periudhën e miratimit të ligjit, sa të çojnë në përfundimin se kufiri maksimal prej 3.000 lekësh për një ditë paraburgim e ka humbur funksionin e tij kushtetues. Po kështu, kushtetutshmëria e dispozitës nuk mund të vlerësohet mbi bazën e rasteve hipotetike ose të supozimit se kompensimi mund të rezultojë i pamjaftueshëm për individë me të ardhura veçanërisht të larta.

Në përfundim, Gjykata vlerësoi se togfjalëshi "*3.000 (tre mijë) lekë për një ditë paraburgim*", nuk bie ndesh me nenin 44 të Kushtetutës, ndaj pretendimi i gjykatës referuese është i pabazuar.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE

E drejta e aksesit - Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

Dhimë Qurku, Anastasia Qurku

Dëmshpërblimi për shkak të humbjes së jetës së familjarit dhe përgjegjësia ligjore e institucioneve shtetërore

Vendimi nr. 55, datë 06.05.2026

FJALË KYÇE

OSHEE/ Linjë ajrore e tensionit të lartë/ Dëm pasuror/ Dëm biologjik/ Dëm moral/ Dëm ekzistencial/ Rregullat e sigurimit teknik/ Aksident me pasojë vdekjen/ Detyrim pozitiv i institucioneve shtetërore/ Stricto sensu

Mospranimi i rekursit të kërkuesve nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin de plano të çështjes dhe me arsyetimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese, për të drejtën e jetës, ka vënë në dyshim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore kushtetuese të kërkuesve, si pasojë e mosmarrjes së masave nga institucioni përgjegjës në përputhje me parashikimet ligjore.

Faktet

Kërkuesit janë prindër të shtetasit Edmond Qurku, i cili humbi jetën si pasojë e kontaktit me linjën elektrike ajrore gjatë vendosjes së një tende. Prokuroria në bazë të të dhënave arriti në përfundimin se, fakti i ndodhur nuk parashikohej si vepër penale dhe vendosi mosfillimin e procedimit penal. Kërkuesit iu drejtuan Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë ku kërkuan dëmshpërblim për dëmin pasuror dhe jopasuror (biologjik, moral, ekzistencial), e cila pranoi kërkesëpadinë e plotë me arsyetimin se vendosja e shtyllave të tensionit 10kV ishte bërë në shkelje të distancave të sigurisë. Mbi ankimin e paraqitur nga OSHEE-ja, Gjykata e Apelit Gjirokastër ndryshoi vendimin e shkallës së parë dhe rrëzoi kërkesëpadinë. Gjykata e Lartë mbi rekursin e paraqitur nga familjarët vendosi mospranimin e tij. Në vijim kërkuesit iu drejtuan Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit – Duke qenë se argumentet e kërkuesve për cenimin e së drejtës së jetës dhe së drejtës për jetë familjare lidhen me të drejtën e jetës, Gjykata vlerësoi t'i shqyrtojë ato në themel në drejtim të së drejtës së aksesit dhe arsyetimit të vendimit gjyqësor duke verifikuar nëse kërkuesit kanë marrë përgjigje përfundimtare për kërkimet e tyre dhe nëse vendimi i Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet kushtetuese të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Sipas gjykatës së rrethit u vlerësua se humbja e jetës së viktimës kishte ardhur si pasojë e mosrespektimit të kushteve dhe standardeve teknike nga OSHEE-ja, kurse gjykata e apelit, megjithëse vlerësoi në të njëjtën linjë si gjykata e shkallës së parë për shkeljen e rregullave teknike, përcaktoi si shkak për aksidentin pakujdesinë e viktimës dhe mungesën e përgjegjësisë së OSHEE-së duke rrëzuar kërkesëpadinë për shpërblimin e dëmit. Gjykata e Lartë edhe pse ndodhej përpara një pretendimi me natyrë kushtetuese, si e drejta e jetës, vlerësoi se rekursi nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga ligji.

Gjykata vlerësoi se gjykata e apelit ka interpretuar formalisht dhe *stricto sensu* kuadrin ligjor duke u mbështetur në dy rregulloret teknike, interpretim i cili nuk ka marrë në konsideratë qëllimin e akteve ligjore duke nxjerrë një përfundim hipotetik dhe përjashtuar a *priori* nga përgjegjësia institucionet që operojnë në fushën e shpërndarjes së energjisë elektrike, ndërsa Gjykata e Lartë, e ka mbështetur vendimin në një arsyetim të përgjithshëm e formal, i cili është kufizuar në pohime standarde për respektimin e normave procedurale dhe zbatimin e ligjit material. Kjo e fundit duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të pretendimit të kërkuesve sa i takon interpretimit të kuadrit ligjor nga gjykata e apelit që mohonte thelbin e së drejtës së jetës, për sa u takon detyrimeve pozitive të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për marrjen e masave për shpërndarjen e energjisë elektrike si fushë që përbën burim rreziku të shtuar edhe për jetën e individit me impakt dhe pasoja të ndjeshme dhe të drejtpërdrejta në sigurinë publike. Në këtë rast është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e pjesshëm të kërkesës (një gjyqtar u shpreh me mendim pakice).

E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj – E drejta e aksesit substancial e lidhur me të drejtën për t'u njoftuar, të drejtën për t'u mbrojtur, të drejtën për t'u dëgjuar dhe parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

FJALË KYÇE

Vrasje me dashje/ Plagosje e lehtë/ Grindje e çastit/ Vlerësim i formës së bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale/ Ripërcaktimi i fakteve/ Bashkëpunim i çastit/ Vlerësim i ndryshëm i provave/ Njoftim i rekursit/ Njoftim i datës së seancës gjyqësore

Duke pasur parasysh natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë, është i pashmangshëm referimi në provat gjyqësore të përcaktuara nga gjykatat e faktit për të interpretuar ligjin në përputhje me to.

Nuk rezulton që Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë të ketë ripërcaktuar faktet e çështjes në tejkalim të kompetencave të njohura nga ligji. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë ka ndjekur procedurën ligjërisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik, duke ushtruar funksionet e saj në përputhje me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë.

Xhonatan Muçaj, Nasi Hodo

Ripërcaktimi i provave dhe fakteve në vlerësimin e bashkëpunimit – njoftimi nga Gjykata e Lartë

Vendimi nr. 56, datë 21.05.2026

Faktet

Kërkuesit u deklaruan fajtorë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë për veprat penale të parashikuara nga nenet 76, 22 dhe 25 të Kodit Penal (KP) në dëm të shtetasit E.M., për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i KP-së në dëm të shtetasit P.B., për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i KP-së në dëm të shtetasit D.K. dhe në bashkim të dënimeve u dënuan përkatësisht me 20 dhe 18 vjet burgim. Mbi ankimin e kërkuesve, Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e shkallës së parë për kërkuesin Xhonatan Muçaj vetëm për veprën penale të parashikuar nga nenet 76, 22 dhe 25 të KP-së duke e dënuar me 12 vjet burgim, ndërsa për kërkuesin Nasi Hodo la në fuqi vendimin e shkallës së parë vetëm për veprën e parashikuar nga neni 89 i KP-së, duke e dënuar me dy vjet burgim dhe duke urdhëruar lirim të menjëhershëm nga paraburgimi. Mbi rekursin e prokurorisë, Gjykata e Lartë vendosi prishjen e vendimit të apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë. Në vijim, kërkuesit iu drejtuan Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj – Gjykata konstatoi se, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se të pandehurit (kërkuesit) kishin vepruar si ekzekutorë të vetëm ndaj viktimave, por qëllimi i tyre i përbashkët ka qenë ulja e rezistencës së viktimave me çdo mjet dhe kusht, përfshirë dhe përdorimin e mjeteve të afta për të shkaktuar vdekjen. Ndërsa gjykata e apelit ka vlerësuar se ishte një grindje e çastit ku secili ka vepruar i ndikuar nga situata e momentit e për rrjedhojë nuk rezultoi i provuar bashkëpunimi mes të pandehurve pasi nuk ka shprehje vullneti për kryerjen e veprimeve të caktuara. Gjykata e Lartë ka gjetur të drejtë arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se jurisprudenca penale njeh si formë të bashkëpunimit edhe bashkëpunimin e çastit, një formë e thjeshtë bashkëpunimi, e lindur aty për aty, në kryerje e sipër të veprës penale dhe që plotëson kuadrin për ta konsideruar atë si të kryer në bashkëpunim. Gjykata e Lartë nuk ka bërë një ripërcaktim të fakteve, por i është përmbajtur në analizën e vet ligjore të njëjtave fakte të konstatuara prej gjykatave më të ulëta. Në analizë të fakteve të përcaktuara nga gjykatat më të ulëta, në thelb, kjo gjykatë ka vlerësuar, nëse ligjërisht mund të kishte bashkëpunim ndërmjet kërkuesve. Referimi që bën Gjykata e Lartë në provat e administruara nga gjykatat më të ulëta, që nuk mund të shihet i shkëputur nga provat e vlerësuara nga këto gjykata, është në funksion të dhënies së një vendimi të arsyetuar nga ana e saj dhe i shërben argumenteve në mbështetje të konceptit juridik të bashkëpunimit.

Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial – Në lidhje me pretendimin *për cenimin e së drejtës së aksesit substancial* të lidhur me *të drejtën për t'u njoftuar, për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, , kërkuesi Xhonatan Muçaj ka parashtruar se Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për zhvillimin e procesit penal, ndërsa kërkuesi Nasi Hodo se mosnjoftimi personalisht i rekursit, i ka mohuar të drejtën të paraqiste kundërrekurs dhe parashtrime në

(vijon në faqen 11)



seancën gjyqësore. Gjykata gjatë shqyrtimit të dosjes gjyqësore verifikoi, nëse kërkuesit ishin njoftuar për rekursin e prokurorisë dhe për zhvillimin e procesit gjyqësor dhe në procesverbalin gjyqësor të datës 10.12.2024, rezultoi se palët kishin marrë dijeni rregullisht sipas ligjit, me anë të shpalljes publike të datës 07.11.2024.

Në procesverbalin e seancës së datës 17.12.2024, përsëritet i njëjti konstatim. Në përfundim, Gjykata vlerësoi se gjykatat e zakonshme kanë përdorur me diligjencën e nevojshme mjetet në dispozicion të tyre, si për njoftimin e rekurseve ashtu dhe për datën e gjykimit në Gjykatën e Lartë sipas nenit 436, pika 3, të Kodit të Procedurës Penale.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (tre gjyqtarë u shprehën me mendim pakice).

Liria personale në aspektin procedural: E drejta e mbrojtjes – Parimi *reformatio* in peius (mosrëndimi i pozitës së të pandehurit)

Liria personale në aspektin substancial: Standardi i dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova – Parimi i prezumimit të pafajësisë – Dinjiteti

FJALË KYÇE

Kryetar i Bashkisë/ Kallëzim/ Shpërdorim i fondeve publike/ Dyshim i arsyeshëm/ "Arrest në burg"/ "Helmim" i provave/ Individualizim i masës së sigurimit personal/ Qëndrimi në kafaz/ kabinën e xhamit gjatë seancës gjyqësore/ Efektiviteti i mbrojtjes/ Përshtatshmëria e masës së sigurimit personal

Referuar neneve 28 dhe 42 të Kushtetutës, në procedurat që lidhen me kontrollin gjyqësor të heqjes së lirisë duhet të ruhet një ekuilibër i drejtë ndërmjet kërkesës për shpejtësinë e këtij kontrolli dhe së drejtës për mbrojtje efektive.

Afatet e shkurtra që karakterizojnë këtë procedurë janë, në vetvete, garanci për lirinë personale, pasi synojnë të sigurojnë kontrollin e menjëhershëm gjyqësor të heqjes së lirisë dhe parandalimin e çdo kufizimi arbitrar të saj.

Erion Veliaj

Proporcionaliteti i kufizimit të lirisë personale i lidhur me të drejtën për t'u zgjedhur dhe trajtimin me dinjitet gjatë procesit gjyqësor

Vendimi nr. 57, datë 25.05.2026

Faktet

Prokuroria e Posaçme, bazuar në materialet e referuara mbi aktin në formën e kallëzimit penal me shkrim, të bërë nga shtetasi i vetidentifikuar si N.A., regjistroi procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal (KP). Pas hetimeve u krijua dyshimi i arsyeshëm se, kërkuesi ishte i përfshirë në një sistem të organizuar korrupsioni dhe shpërdorimi të fondeve publike ku nëpërmjet nënshkrimit të tij përcaktues në shpërndarjen e këtyre fondeve, ai dhe familjarët e ngushtë kishin përfituar në mënyrë të parregullt. Mbi këtë bazë në datën 24.01.2025, u regjistrua emri i tij si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 260 e 25 dhe 287, paragrafi i dytë, të KP-së dhe po në këtë datë, prokuroria kërkoi caktimin e masës së sigurimit personal ndaj tij. Në datën 09.02.2025, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO-ja e Shkallës së Parë) caktoi masën e sigurimit "Arrest në burg" ndaj kërkuesit e cila u ekzekutua në datën 10.02.2025. Mbi kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për verifikimin e kushteve dhe kritereve të zbatimit të masës së sigurimit, në datën 12.02.2025, GJKKO-ja e Shkallës së Parë vendosi vazhdimin e zbatimit të kësaj mase, që u miratua nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO-ja e Apelit) me vendimin e datës 13.03.2025, kurse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në datën 08.07.2025, la në fuqi vendimin e GJKKO-së së Apelit. Kërkuesi, në datën 21.11.2025, iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Vlerësimi i Gjykatës

Për lirinë personale në aspektin procedural

Për të drejtën e mbrojtjes – Gjykata analizoi pretendimet e kërkuesit sa i takon mbrojtjes efektive:

i) *në drejtim të kohës për t`u njohur me aktet e dosjes* – Për sa i përket pretendimit për njohjen me aktet gjatë gjykimit në shkallë të parë, bëhet fjalë për një çështje me akte voluminoze duke pasur parasysh numrin e personave nën hetim dhe natyrën e veprave penale për të cilat ata dyshohen. Kërkuesi dhe mbrojtësit e tij janë vënë në dijeni të këtyre shkaqeve me njoftimin e vendimit të caktimit të masës së sigurimit, duke pasur që nga ky moment mundësinë për të kërkuar njohjen me aktet e hetimit dhe pajisjen me kopje të tyre. Në vijim, me kërkesën e tyre në seancë gjyqësore, gjykata u ka dhënë afat shtesë me qëllim konsultimin me aktet. Megjithëse koha ka qenë e kufizuar në raport me volumin e akteve, nuk rezulton që mbrojtja të jetë vënë në pamundësi reale për të parashtruar kundërshtimet e saj, për të paraqitur prova dhe për të ushtruar ankimin ndaj masës. Për sa i përket pretendimit për mospasjen e kohës së mjaftueshme për t`u njohur dhe debatuar në lidhje me provat e paraqitura nga Prokuroria e Posaçme në GJKKO-në e Apelit, rezulton se mbrojtësit e kërkuesit janë njohur me apelin kundërshtues të prokurorisë dhe me provat e paraqitura rishtazi përpara asaj gjykate, duke pasur mundësinë të kundërshtojnë administrimin e tyre, zbatimin e dispozitave procedurale penale dhe të debatojnë në lidhje me përmbajtjen e tyre. Për më tepër, kërkuesi ka pasur mundësinë t'i parashtrojë këto pretendime edhe në Gjykatën e Lartë.

(vijon në faqen 13)

Megjithatë, kjo garanci duhet të jetë në ekuilibër të drejtë me të drejtën e të arrestuarit për mbrojtje efektive, e cila kërkon që ai dhe mbrojtësi i tij të kenë akses të mjaftueshëm në aktet thelbësore të procedimit penal dhe kohë të arsyeshme për t'i shqyrtuar ato, edhe kur janë voluminoze, në funksion të kundërshtimit të masës së caktuar.

Ndonëse Gjykata e Lartë ka evidentuar standardin e kontrollit të ligjshmërisë së vendimit objekt rekursi dhe ka mbështetur arsyetimin e gjykatave të posaçme për ekzistencën e rreziqeve dhe nevojave të sigurimit, ajo nuk ka ushtruar një kontroll efektiv mbi pretendimet thelbësore të kërkuesit në lidhje me proporcionalitetin e masës "Arrest në burg", si dhe nuk ka verifikuar nëse rreziqet dhe nevojat e sigurimit ishin individualizuar në mënyrë konkrete, nëse masa më e rëndë e caktuar ishte vërtet e domosdoshme, nëse masat më pak kufizuese ishin realisht të pamjaftueshme, si dhe pasojat e kësaj mase mbi të drejtën e kërkuesit për t'u zgjedhur.

ii) *në drejtim të së drejtës për të komunikuar lirisht me mbrojtësit, për shkak të qëndrimit në kafaz/kabinën e xhamit* – Kërkuesi nuk është vënë në pamundësi për të komunikuar ose për t`u konsultuar me mbrojtësit e tij, si dhe të ketë ngritur shqetësim të tillë konkret. Ai ka kërkuar dhe është lejuar të deklarojë dhe parashtrojë qëndrimin e tij në lidhje me verifikimin e kritereve ligjore që justifikojnë masën kufizuese të lirisë. Në këndvështrimin kushtetues nuk konstatohet, se në ç' mënyrë kjo formë e zhvillimit të seancës gjyqësore e ka vënë kërkuesin në pamundësi objektive për të komunikuar lirisht me mbrojtësin gjatë seancës apo për t`u konsultuar me të me qëllim ushtrimin e një mbrojtjeje efektive.

Për parimin "reformatio in peius" (mosrëndimi i pozitës)- Në lidhje me këtë pretendim Gjykata nuk arriti shumicën e kërkuar nga ligji për vendimmarrje.

Sipas njërit qëndrim, marrja e provave dokumentare të sjella në apel nga prokuroria, është kryer në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe nuk ka sjellë rëndim të pozitës për kërkuesin.

Sipas një qëndrimi tjetër, mbi bazën e këtyre provave të reja gjykata e apelit ka vlerësuar në drejtim të ekzistencës së kushteve dhe kritereve për caktimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit, ndërkohë që vlerësimi i Gjykatës së Lartë në këtë drejtim ka qenë formal, duke mos ushtruar funksionin e saj në interpretimin përfundimtar të dispozitave ligjore nga gjykatat e zakonshme dhe raportin mes tyre.

Sipas një qëndrimi tjetër, pretendimi se përdorimi dhe pranimi i këtyre provave solli përkeqësimin e pozitës procedurale të kërkuesit, ngre çështje që lidhen me kufijtë e shqyrtimit në apel, bazën ligjore për pranimin e provave të reja në këtë fazë, si dhe garancitë e mbrojtjes efektive, kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, prandaj i takonte Gjykatës së Lartë t'i jepte përgjigje të plotë dhe të mjaftueshme këtij pretendimi.

Për lirinë personale në aspektin substancial – Gjykata e vlerësoi ta shqyrtojë çështjen:

i) në drejtim të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova të lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë – Në lidhje me pretendimet e kërkuesit për përdorimin e një gjuhe fajësuese (paragjykuese për fajësinë) përtej kuptimit literal të disa fjalëve e fjalive, duke mbajtur parasysh faktin se vendimet e kundërshtuara janë tejet voluminoze, si dhe duke i vendosur pasazhet e kontestuara në kontekstin e gjerë të vendimeve dhe të kësaj faze të procesit, Gjykata vlerëson se pavarësisht dyshimeve në dukje, në tërësinë e tyre, arsyetimet e gjykatave të masës së sigurimit janë qartësisht të fokusuara te vërtetimi i ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm të bazuar mbi prova se i akuzuari (kërkuesi) mund t'i ketë kryer veprat penale të cilat i atribuohen nga organi i akuzës, si dhe te vërtetimi i kushteve dhe kritereve të tjera të parashikuara nga ligji për kufizimin e lirisë në këtë fazë të procesit penal.

Në lidhje me sa i takon pretendimeve, që u referohen arsyetimeve të gjykatave lidhur me rrezikshmërinë e kërkuesit duke marrë shkas nga komunikimet me një hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), postimet dhe deklaratat publike, si dhe bashkëpunimi me të hetuarit e tjerë, veprime këto që u konsideruan se kishin tiparet e një bashkëpunimi të posaçëm, atij të grupit të strukturuar kriminal, këto arsyetime janë shtuar nga GJKKO-ja e Apelit që i ka vlerësuar në këndvështrim të analizës së saj për verifikimin e ekzistencës së kushteve dhe kritereve të tjera që lejonin kufizimin e lirisë personale. Pavarësisht deklarimeve të GJKKO-së së Apelit në këtë drejtim, ato nuk janë të tilla që të përbëjnë shprehje/deklarim të fajësisë së kërkuesit përpara se ajo të vendoset me vendim të formës së prerë.

(vijon në faqen 14)



Për më tepër, edhe Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ky pretendim ka marrë përgjigje në vendimin e vetë gjykatës së apelit, duke u shprehur se një formë e tillë bashkëpunimi nuk i është atribuuar ende personave në hetim, për rrjedhojë, nuk merret në konsideratë në këtë moment të procedurës, pra në caktimin e llojit të masës së sigurimit, pasi në të kundërt do të cenohej parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit.

ii) *në drejtim të proporcionalitetit të masës së lidhur edhe me të drejtën për t'u zgjedhur* – Gjykata e Lartë nuk ka verifikuar mjaftueshëm pretendimin e kërkuesit se masat alternative mund të kishin aftësinë të neutralizonin rreziqet konkrete të identifikuara. Pretendimi mbi proporcionalitetin e masës të lidhur edhe me pasojat mbi të drejtën për t'u zgjedhur, në ushtrimin efektiv të funksionit të tij publik, meritonte përgjigje të posaçme nga Gjykata e Lartë, e cila ka arsyetuar se statusi i kërkuesit si subjekt i posaçëm dhe funksionar publik përforconte rrezikshmërinë dhe potencialin për ndikim në procedim, pa dhënë një përgjigje të veçantë për pretendimin se masa e arrestit, për shkak të natyrës dhe intensitetit të saj, ndikonte edhe në ushtrimin efektiv të funksionit. Ky përfundim nuk nënkupton se funksioni i kryetarit të bashkisë, në vetvete, e përjashton zbatimin e masave të sigurimit personal ose se interesi për ushtrimin e këtij funksioni ka përparësi absolute ndaj nevojave të procedimit penal, por kjo nuk e përjashtonte nevojën që Gjykata e Lartë t'i jepte përgjigje pretendimit se masa e kundërshtuar sillte pasoja edhe mbi ushtrimin efektiv të një funksioni publik të fituar përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta.

Për dinjitetin e kërkuesit të lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë – Ky pretendim ka të bëjë me dinjitetin të lidhur me trajtimin në sallën e gjyqit përpara gjykatës (autoriteteve publike), por edhe në sytë e publikut, si dhe me parimin e prezumimit të pafajësisë të lidhur me perceptimin në drejtim të fajësisë së tij, argumente këto me natyrë thellësisht kushtetuese, si dhe duke pasur parasysh dhe rëndësinë që ka një çështje e tillë në përgjithësi dhe në rastin konkret edhe për shkak të interesit të lartë publik që mbart ky proces penal, duhej të ishte shqyrtuar nga Gjykata e Lartë e cila duhej të kishte dhënë përgjigje të arsyetuar në këtë drejtim.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e pjesshëm të kërkesës (4 gjyqtarë u shprehën me mendim paralel, 1 gjyqtar me mendim pjesërisht paralel, 1 gjyqtar me mendim pakice dhe 3 gjyqtarë secili me mendim pjesërisht kundër).

E drejta e pronës – Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

Ajlin Sharku, Kenin Sharku

Marrja e provës me dëshmitar për verifikimin nga gjykata të kryerjes së pagesës për blerje pasurie të paluajtshme në mungesë të një akti noterial

Vendimi nr. 58, datë 26.05.2026

FJALË KYÇE

Kredi hipotekore/ Pavlefshmëri e veprimit juridik të shitjes/ Kamatëvonesë/ Provë me dëshmitarë/ Kontratë verbale

Cilësimi i rrethanave të mosmarrëveshjes e identifikimi dhe interpretimi i ligjit procedural e material nga gjykatat i është nënshtruar më pas kontrollit të ligjshmërisë nga Gjykata e Lartë, e cila, në përputhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, u ka dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të ngritura nga kërkuesit në rekurs.

Faktet

Kërkuesit janë trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit L.S., i cili kishte blerë me kredi bankare dhe vendosur në hipotekë një apartament në Tiranë. Subjektet e interesuara Kimete dhe Albert Hoxha, emta e të ndjerit dhe djali i saj, kanë pretenduar blerjen e këtij apartamenti nëpërmjet pagimit të vlerës përkatëse të ndjerit në një drekë familjare, në prani dhe të vëllezërve të tij, veprim ky që nuk është finalizuar me akt noterial, për shkak se L.S. ndërroi jetë papritur. Në kushtet kur gjykatat e zakonshme kanë pranuar kërkesën e kërkuesve për dorëzimin nga subjektet e interesuara të apartamentit, këta të fundit nisën proces gjyqësor, duke kërkuar kthimin nga kërkuesit të shumave që i kishin paguar të ndjerit për blerjen e apartamentit, shlyerjen e kredisë, si dhe kamatëvonesat mbi këtë shumë.

Gjykata e shkallës së parë, për qëllim të përcaktimit dhe verifikimit të fakteve, gjatë shqyrtimit të çështjes thirri si dëshmitarë vëllezërit e të ndjerit të cilët pranuan pagesën e bërë nga subjektet e interesuara. Kjo gjykatë, mbështetur dhe mbi vërtetimin bankar (prova "dokument") mbi shlyerjen e kredisë nga subjektet e interesuara, pranoi pjesërisht kërkesëpadinë duke detyruar kërkuesit t'i kthenin shumat e paguara për blerjen e apartamentit dhe shlyerjen e kredisë Kimete e Albert Hoxhës, ndërsa rrëzoi kërkimin për kamatëvonesat. Mbi ankimin e kërkuesve, Gjykata e apelit la në fuqi vendimin e shkallës së parë dhe Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit të tyre. Në vijim, kërkuesit iu drejtuan Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës – Në lidhje me pretendimet e kërkuesve se arsyetimet e vendimeve të gjykatave të zakonshme janë kontradiktore, pasi nga njëra ana pranojnë marrjen e provës me dëshmitarë për të vërtetuar pagesën dhe nga ana tjetër konstatojnë pavlefshmërinë e veprimit juridik të shitjes së apartamentit, Gjykata verifikoi, nëse këto vendimmarrje kanë identifikuar dhe pasqyruar qartë faktet e çështjes dhe dispozitat ligjore të zbatueshme dhe nëse kanë patur argumente të mjaftueshme për të mbështetur përfundimet e tyre. Vendimi i gjykatës së rrethit u vlerësua i drejtë dhe i bazuar në ligj nga apeli me të njëjtin arsyetim, ndërsa Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se gjykatat më të ulëta kishin vepruar në respektim të normave procedurale dhe materiale, duke bërë cilësim të drejtë të fakteve dhe të rrethanave dhe analizë të plotë juridike të provave dhe se interpretimi që gjykata e rrethit dhe ajo e apelit i kishin bërë nenit 233 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) për marrjen dhe vlerësimin e provave me dëshmitar ishte i drejtë, ndërsa në kuptim të neneve 106 e 674 të Kodit Civil, pavlefshmëria e veprimit juridik nuk mund të përbënte rrethanë për përfitimin pa të drejtë nga kërkuesit të shumës së çmimit që paditësit kishin paguar në mirëbesim për qëllime të realizimit të veprimit juridik. Gjykata vëren se gjykatat e faktit kanë marrë në shqyrtim e analizuar pretendimet e kërkuesve dhe kanë mbajtur qëndrim të shprehur për shkaqet që i kanë çuar në rrëzimin e tyre, duke dhënë argumente të mjaftueshme. Vendimmarrjet e tyre nuk janë mbështetur vetëm në dëshmitë, por edhe në një sërë provash të tjera të paraqitura në gjykim nga palët.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

E drejta e aksesit – Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

Xhevat Topi

Efektet juridike të Rregullores së AMF-së

Vendimi nr. 59, datë 28.05.2026

FJALË KYÇE

Aksident rrugor/ Përllogaritje e dëmit/ Dëm jopasuror/ Vendim unifikues nr.12/2007 i Gjykatës së Lartë/ Rregullore nr. 53/2009 e AMF-së

Dyshimet në lidhje me veprimin në kohë të normave juridike duhet të zgjidhen nga gjykatat e zakonshme, bazuar në parashikimet kushtetuese që përcaktojnë momentin e hyrjes në fuqi të tyre (neni 117 i Kushtetutës), si edhe bazuar në parimin kushtetues të hierarkisë së akteve ligjore (nenet 4 dhe 116 të Kushtetutës), nga të cilat burojnë edhe parimet ku bazohen gjykatat për përcaktimin e ligjit të zbatueshëm në rast të përplasjeve mes normave me fuqi të njëjtë ose të ndryshme juridike.

Pretendimet e ngritura në rekurs për sa i përket identifikimit dhe zbatimit nga ana e gjykatës së apelit të ligjit të zbatueshëm në thelb, kanë të bëjnë me parimet e sigurisë juridike dhe të hierarkisë së akteve, ashtu sikundër edhe me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, që kanë natyrë kushtetuese.

Faktet

Kërkuesi, trashëgimtar i të birit të ndjerë, i cili ka humbur jetën në një aksident automobilistik, së bashku me bashkëshorten iu drejtuan Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi për shpërblimin e dëmit jopasuror (dhe interesat). Kërkesëpadia u pranua nga gjykata e cila vendosi dhe dëmshpërblimin në shumën 4.000.000 lekë, plus interesat. Mbi ankimin e kërkuesit dhe bashkëshortes së tij, Gjykata e Apelit vendosi uljen e vlerës së dëmshpërblimit në 800.000 lekë, kurse Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekurseve të të dyja palëve ndërgjyqëse. Në vijim, kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor – Kërkuesi në të gjitha shkallët e gjykimit ka pretenduar moszbatimin e Rregullores nr. 53/2009, të AMF-së, me arsyetimin se nuk kishte hyrë në fuqi në momentin e ndodhjes së aksidentit, pasi nuk ishte botuar në Fletoren Zyrtare. Gjykata konstatoi se gjykatat e faktit kanë çmuar se, ligji i zbatueshëm në rastin konkret ishte ligji në fuqi në momentin e ndodhjes së aksidentit, pra ligji nr. 10076/2009, por sa i takon përllogaritjes së masës së dëmshpërblimit, gjykata e shkallës së parë i është referuar vendimit unifikues nr. 12/2007, ndërsa gjykata e apelit e ka konsideruar këtë të gabuar dhe ka pranuar përllogaritjen e ekspertit në bazë të rregullores nr. 53/2009, të AMF-së, ndonëse nuk ka referuar shprehimisht në këtë të fundit, ndërsa Gjykata e Lartë nëpërmjet arsyetimit të kufizuar nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit kryesor të kërkuesit mbi kuadrin ligjor të zbatueshëm.

Gjykata vlerësoi se, kjo situatë kërkonte nga Gjykata e Lartë që në ushtrim të rolit të saj të verifikonte mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta dhe të mbante një qëndrim të shprehur dhe të arsyetuar në drejtim të kuadrit ligjor të zbatueshëm në rastin konkret me qëllim që kërkuesi të merrte përgjigje për sa i takon zbatueshmërisë së kuadrit ligjor në çështjen objekt shqyrtimi. Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me arsyetimin de plano se shkaqet e rekursit nuk ishin ato të parashikuarat nga ligji, pa u dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve me natyrë kushtetuese, të çon në përfundimin se zbatimi i ligjit nga ajo vë në dyshim të drejtën e procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e kërkesës (një gjyqtar u shpreh me mendim kundër).

E drejta e aksesit – Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor – E drejta e jetës në aspektin procedural

FJALË KYÇE

Viktimë e veprës penale/ Hetim efektiv/ Parashkrim i ndjekjes penale/ Pushim i procedimit penal/ Kallëzim penal/ Afat 10 ditor i ankimit/ Njoftim i vendimit

Fakti se procedimi penal ishte pushuar për shkak të parashkrimit nuk e përjashtonte detyrimin e Gjykatës së Lartë për të verifikuar nëse pretendimet për mënyrën e zhvillimit të hetimit kishin marrë një përgjigje në përputhje me standardet kushtetuese.

Për rrjedhojë, Gjykata theksoi se ky përfundim nuk nënkupton vlerësimin prej saj nëse hetimi ka qenë efektiv, se vepra penale duhej të kishte një cilësim juridik të ndryshëm ose se ndjekja penale nuk ishte parashkruar. Shqyrtimi i këtyre çështjeve u përket autoriteteve të ndjekjes penale dhe gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, sipas kompetencave të tyre. Në këtë fazë, i takon Gjykatës së Lartë, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, t'u japë përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs.

Sanie Metushi, Dudi Shabani (Metushi)

Afati i parashkrimit të ndjekjes penale dhe mungesa e arsyetimit nga Gjykata e Lartë në raport me aspektin procedurial të së drejtës së jetës

Vendimi nr. 60, datë 28.05.2026

Faktet

Kërkueset janë nëna dhe motra e shtetasit B.M. (viktima) i gjetur i vrarë në datën 25.09.1996, në Greqi, ngjarje për të cilën janë zhvilluar hetime, si në Greqi, ashtu dhe në Shqipëri. Në datën 10.03.1999, Gjykata e Shkallës së Parë të Larisës arkivoi çështjen për procedimin penal të regjistruar nga autoritetet greke për veprat penale të vrasjes me paramendim dhe të përdorimit të armës ndaj shtetasve shqiptarë të akuzuar për ngjarjen. Mbi bazën e kallëzimit penal të bërë nga xhaxhai i viktimës, në datën 29.11.1996, Prokuroria e Fierit regjistroi procedim penal dhe me urdhër të prokurorit u ndaluan shtetasit F.A., A.M. dhe M.T., si autorë të mundshëm të vrasjes. Në datën 01.12.1996, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier caktoi masën e sigurimit personal "Arrest në burg", ndaj tyre me afat një muaj dhe në datën 25.03.2001, Prokuroria e Fierit vendosi pezullimin e hetimeve, me shkakun se nuk ishte zbuluar autori i veprës penale. Prokuroria e Fierit u kërkoi autoriteteve greke konfirmimin e ekzistencës së faktit penal, informacion nëse ishte ushtruar ndjekje penale në atë shtet dhe për personat e dyshuar, si dhe, nëse ekzistonte procedim penal ndaj shtetasve shqiptarë, transferimin e tij ose vënien në dispozicion të akteve përkatëse dhe në përgjigje, në datën 04.08.2009, autoritetet greke dërguan aktet e procedimit penal. Prokuroria e Fierit, në datë 01.09.2009, rifilloi hetimet, mbi bazë të materialeve të dërguara, por në datën 28.10.2009, vendosi pezullimin e tyre për të njëjtin shkak si herën e parë, vendim ky që u revokua në datën 27.01.2017, dhe u vendos pushimi i procedimit penal me arsyetimin se ndjekja penale ishte parashkruar sipas nenit 66 të Kodit Penal (KP). Prokurori urdhëroi njoftimin e vendimit personave që kishin bërë kallëzim. Në datën 08.07.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, pasi shqyrtoi kërkesën e kërkueseve për shfuqizimin e vendimit dhe vazhdimin e hetimeve, la në fuqi vendimin e pushimit të procedimit penal, me arsyetimin se ankimi ishte paraqitur jashtë afatit ligjor dhe se vendimi i prokurorit që ndjekja penale ishte parashkruar, ishte marrë në zbatim të ligjit. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë u la në fuqi nga gjykata e apelit me të njëjtin arsyetim, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Në vijim, kërkueset iu drejtuan Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhura me aspektin procedural të së drejtës për jetën – Gjykata vëren se, *për sa i përket pretendimit për mungesën e njoftimit të vendimit për pushimin e procedimit penal*, në fashikullin e hetimit nuk rezulton ndonjë akt që provon dërgimin dhe marrjen tij nga kallëzuesi ose familjarët e viktimës. Gjykatat e faktit kanë lidhur marrjen dijeni të vendimit me shkresat e Prokurorisë së Fierit dhe faktin se avokatëve të caktuar nga babai i viktimës u ishin vënë në dispozicion akte të dosjes duke vlerësuar kështu ankimin e tyre si të paraqitur jashtë afatit ligjor. Megjithatë, gjykatat e faktit kanë analizuar dhe zbatimin e nenit 66 të KP-së duke arritur në përfundimin se ndjekja penale ishte parashkruar. Në këto kushte, pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë për shkak të mungesës së njoftimit nuk është i bazuar. Për sa i takon pretendimit të kërkueseve për mungesën e një hetimi të plotë dhe efektiv për vdekjen e familjarit të tyre, nga vendimet rezulton se analiza nuk është shtrirë në

(*vijon në faqen 18)*



mënyrë të veçantë te pretendimet e kërkueseve për zhvillimin e hetimit në raport me aspektin procedural të së drejtës për jetën.

Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në arsyetimin e tij ndonëse në rekurs ishin parashtruar argumente konkrete për kohëzgjatjen dhe mangësitë e pretenduara të hetimit, nuk ka vlerësuar natyrën e tyre kushtetuese dhe as nuk ka analizuar nëse gjykatat më të ulëta u kishin dhënë përgjigje në raport me aspektin procedural të së drejtës për jetën e veçanërisht nuk ka shpjeguar se përse argumentet që vinin në diskutim përmbushjen e detyrimit procedural që buron nga e drejta për jetën nuk kërkonin një përgjigje të shprehur në kuadër të shqyrtimit të rekursit. Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë nuk ka siguruar një kontroll gjyqësor efektiv të pretendimit me natyrë kushtetuese të ngritur nga kërkueset.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e pjesshëm të kërkesës (tre gjyqtarë u shprehën me mendim pakice).

E drejta e aksesit substancial – Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

Fatmir Lala, Valbona Lala, Fatbardh Lala, Griselda Lala dhe Ortigo Lala

Dëmshpërblimi për shkak të humbjes së jetës së familjarit

Vendimi nr. 61, datë 28.05.2026

FJALË KYÇE

Ashensor i amortizuar/ Aksident me pasojë vdekjen/ Paligjshmëri veprimi ose mosveprimi/ Lidhje shkakësore veprim-pasojë/ Pronare e godinës/ Shoqëri qiramarrëse/ Shpërblim dëmi pasuror, jopasuror/ Përgjegjësi solidare

Në vendimin e saj, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se përgjegjësia për dëmin zhvendosej te shoqëritë qiramarrëse, ndërsa nuk ka shpjeguar se përse, pavarësisht këtij përfundimi, e ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, i cili kishte refuzuar thirrjen e këtyre shoqërive në gjykim. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë nuk i ka kthyer përgjigje edhe pretendimit të kërkuesve për refuzimin, nga gjykata e shkallës së parë, të kërkesës për thirrjen në gjykim të dy shoqërive qiramarrëse. Po kështu, Gjykata e Lartë, edhe pse ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, nuk ka analizuar se përse është i gabuar arsyetimi i asaj gjykate (së apelit) në lidhje me përgjegjësinë solidare të të tria shoqërive (asaj pronare të godinës dhe dy shoqërive qiramarrëse) në shkaktimin e dëmit.

Faktet

Kërkuesit Fatmir Lala, Valbona Lala, Fatbardh Lala, Griselda Lala dhe Ortigo Lala janë familjarët e të ndjerit K.L., i cili humbi jetën më 26.08.2016, në moshën 15-vjeçare, pasi ra në gropën e një ashensori mallrash në ambientet e shoqërisë "Albantic" sh.p.k., ku punonte nëna e tij. Shoqëria "Pro-Plast" sh.p.k. pronare e godinës (e thirrur si subjekt i interesuar), ia kishte dhënë me qira ndërtesën dy shoqërive "Albantic" sh.p.k. dhe "Derrigal" sh.p.k., për afatin kohor nga data 01.01.2015 deri në datën 31.12.2016.

Pas ngjarjes, prokuroria vendosi fillimisht mosfillimin e procedimit penal, duke vlerësuar se mungonin elementet e veprës penale. Ky vendim u kundërshtua nga nëna e viktimës dhe, me vendim gjyqësor, në vitin 2019, u urdhërua vijimi i hetimeve. Gjatë hetimit u ngritën akuza ndaj administratorëve të shoqërive "Pro-Plast" sh.p.k. dhe "Derrigal" sh.p.k. për shkelje të rregullave të mbrojtjes në punë, ndërsa më pas u morën të pandehur edhe vetë personat juridikë.

Në vitin 2017, kërkuesit ngritën padi civile kundër shoqërisë "Pro-Plast" sh.p.k., duke kërkuar dëmshpërblim për dëmet pasurore dhe jopasurore, morale dhe ekzistenciale, të shkaktuara nga humbja e jetës së familjarit. Gjatë gjykimit, nga ekspertiza teknike u evidentua se ashensori ishte në gjendje të amortizuar dhe nuk ishin kryer kontrollet e nevojshme teknike (duke mos plotësuar kushtet e sigurisë), çka u konsiderua si një nga shkaqet kryesore të aksidentit.

Gjykata e Shkallës së Parë e rrëzoi padinë, duke arsyetuar se përgjegjësia nuk i takonte pronarit të objektit, pasi në momentin e aksidentit ndërtesa administrohej nga shoqëritë qiramarrëse. Ndërsa, gjykata e apelit vlerësoi se pronari i godinës, së bashku me dy shoqëritë qiramarrëse kishin përgjegjësi solidare.

Pas rekursit të paraqitur nga shoqëria "Pro-Plast" sh.p.k., Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë prishi vendimin e gjykatës së apelit dhe la në fuqi vendimin e shkallës së parë. Ai/Kolegji vlerësoi se përgjegjësia për sigurinë e ashensorit i takonte subjektit që kishte në përdorim dhe administrim efektiv ndërtesën sipas kontratës së qirasë, ndërsa pronari nuk kishte kryer veprime ose mosveprime të paligjshme që të krijonin lidhje shkakësore me dëmin. Në vijim kërkueset iu drejtuan Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit - Gjykata konstatoi se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për çështjet e faktit dhe, për pasojë, edhe për sa i përket zbatimit të ligjit material në drejtim të përcaktimit të përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit.

Ndonëse Gjykata e Lartë e ka bazuar analizën e saj mbi të njëjtat fakte dhe prova të administruara gjatë gjykimit në gjykatat e faktit, përfundimi i saj për përjashtimin e përgjegjësisë së pronares së godinës, mbështetet në një interpretim të kontratave të qirasë, i cili nuk gjen mbështetje dhe nuk harmonizohet në përmbajtjen objektive të

(*vijon në faqen 20)*



tyre, në kuptimin që nuk analizon në mënyrë shteruese detyrimet e të gjitha palëve në kontratat e qirasë, si dhe nuk mbështetet në faktet e pranuara prej saj dhe nga gjykatat e faktit. Në këto kushte, përfundimi për përjashtimin e përgjegjësisë së pronares nuk është rezultat i një analize të plotë dhe logjikisht të lidhur të dispozitave kontraktore dhe ligjore të zbatueshme.

Gjykata vlerësoi se arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk plotëson standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Interpretimi jo i plotë i kontratave të qirasë dhe mosdhënia e një përgjigjeje për përgjegjësinë solidare të shoqërive ka çuar në një zbatim të ligjit që nuk mbështetet në elementet objektive të çështjes dhe, për pasojë, në një vendimmarrje që paraqet elemente arbitrariteti në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të jurisprudencës kushtetuese. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesve për cenimin e *së drejtës së aksesit* në gjykatë të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i bazuar.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e kërkesës (tre gjyqtarë janë shprehur me mendim pakice).

E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

Dashmira Zaro

Kohëzgjatje e paarsyeshme e procesit gjyqësor në gjykatën administrative të apelit

Vendimi nr. 63, datë 02.06.2026

FJALË KYÇE

Dëmshpërblim/ Padi me natyrë civile/ Moskompetencë lëndore e gjykatës administrative/ Vendim i ndërmjetëm për pezullimin e gjykimit/ Ankim i veçantë/ kërkesë për përshpejtim/ Vendimi nr. 78/2019 i KLGJ-së/ Mosha e kërkueses/ Afat 30-ditor/ Neni 471/a i KPC-së

Faktet

Kërkuesja i është drejtuar gjykatës administrative me padi me tre kërkime, për njërin prej të cilëve Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnje ka shpallur moskompetencën lëndore dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente civile. Për dy kërkimet e tjera, ajo gjykatë, me vendim të ndërmjetëm të së njëjtës datë, ka vendosur pezullimin e gjykimit deri në zgjidhjen, me vendim gjyqësor të formës së prerë, të kërkimit për të cilin ishte shpallur moskompetenca lëndore. Kundër vendimit të ndërmjetëm kërkuesja ka paraqitur ankim të veçantë, mbi bazën e të cilit çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit, më datë 03.07.2025. Në datën 22.09.2025, kërkuesja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave. Në datën 25.11.2025, kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual. Ndërkohë, me vendimin e datës 22.01.2026, Gjykata e Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkueses duke arsyetuar se, mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime ose qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, por për shkak të pamundësisë objektive të asaj gjykate për të gjykuar çështjen brenda një afati të arsyeshëm.

Pas shqyrtimit paraprak të ankimit kushtetues individual të kërkueses në datën 09.02.2026, është vendosur kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Ndërkohë, sipas informacionit të datës 20.05.2026, dërguar nga Gjykata Administrative e Apelit, rezulton se çështja e kërkueses është shqyrtuar dhe ajo gjykatë, ka vendosur prishjen e vendimit të ndërmjetëm të pezullimit të gjykimit dhe kthimin e çështjes për vijimin e gjykimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Ankimi kushtetues individual nuk mbeti pa objekt vetëm për shkak se, pas paraqitjes së tij, gjykata e apelit përfundoi shqyrtimin e ankimit të veçantë. Kërkuesja ruan interesin kushtetues për shqyrtim në themel të ankimit kushtetues, pasi konstatimi i shkeljes mund t'i shërbejë për rivendosjen e së drejtës së cenuar në aspektin kompensues.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm - Kërkuesja ruan interesin për shqyrtim në themel të ankimit kushtetues individual, i cili nuk mbetet pa objekt vetëm për shkak se, pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual, gjykata e apelit përfundoi shqyrtimin e ankimit të veçantë.

Gjykimi i ankimit të veçantë në gjykatën e apelit ka zgjatur më shumë se 9 muaj, duke tejkaluar afatin ligjor 30-ditor. Gjykata, në kuptim të rëndësisë së asaj që rrezikon kërkuesja për shkak të vonesës në gjykim, vërejti se çështja e themelit ka të bëjë me pretendimin për shpërblimin e pasurisë që kërkuesja pretendon se i është marrë nga shteti. Ndonëse nuk lidhet drejtpërdrejt me interesa jetësorë që kërkojnë, në çdo rast, trajtim me përparësi, kjo çështje lidhet me të drejtën e pronës. Çështja administrative është prej më shumë se 16 muajsh në shqyrtim përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë dhe shqyrtimi i ankimit të veçantë ndaj vendimit të pezullimit ka zgjatur më shumë se 9 muaj, çka ka cenuar të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

(*vijon në faqen 22)*

Një periudhë e gjatë mosveprimi nga gjykatat nuk mund të justifikohet vetëm me reformën në sistemin e drejtësisë ose me ngarkesën e krijuar për gjyqtarët për shkak të saj.

Ndonëse çështja e themelit ka të bëjë me pretendimin për shpërblimin e pasurisë që kërkuesja pretendon se i është marrë nga shteti, pra nuk lidhet drejtpërdrejt me interesa jetësorë që kërkojnë, në çdo rast, trajtim me përparësi, ajo lidhet me të drejtën e pronës.

Për sa kohë që gjykimi i çështjes administrative të themelit është pezulluar për shkak të vendimit të ndërmjetëm, mosshqyrtimi i ankimit ndaj atij vendimi brenda afatit ligjor ka sjellë mosvijimin e atij gjykimi. Megjithatë, në kushtet kur shqyrtimi i ankimit të veçantë tashmë ka përfunduar, Gjykata u kufizua në konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkueses për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, konstatim i cili i krijon asaj mundësinë të kërkojë korrigjimin e shkeljes sipas rregullimeve ligjore përkatëse.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e kërkesës (tre gjyqtarë u shprehën me mendim pakice).

E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

Alma Lleshi

Kohëzgjatje e paarsyeshme e procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë

Vendimi nr. 64, datë 02.06.2026

FJALË KYÇE

Zgjidhje në mënyrë të menjëhershme e të pajustifikuar e kontratës së punës/ Pavlefshmëri e zgjidhjes së kontratës së punës/ Rikthim në vendin e mëparshëm të punës/ Dëmshpërblim/ Afat njoftimi/ procedurë e zgjidhjes së kontratës së punës/ Shpërblim për vjetërsinë në punë/ Leje vjetore/ afat ligjor 2-vjeçar/ Kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm/ Përshpejtim i procedurave të gjykimit/ Nenet 399/1 e vijues të KPC-së/ Neni 399/5 i KPC-së

Standardi i nenit 42 të Kushtetutës nuk kufizohet vetëm në mungesën e fajit subjektiv të gjyqtarit relator ose të gjykatës konkrete, por kërkon të vlerësohet nëse shteti, përmes autoriteteve përgjegjëse për organizimin, administrimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë, ka marrë masat e nevojshme ligjore, institucionale dhe organizative për të garantuar shqyrtimin e çështjeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm.

Faktet

Kërkuesja ka qenë e punësuar si mësuese, për disa vite, deri në momentin e zgjidhjes së kontratës së punës me vendim të drejtorisë së shkollës, me arsyetimin se kishte përfunduar afati i parashikuar në kontratë. Kërkuesja i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, duke kërkuar pavlefshmërinë e zgjidhjes së kontratës së punës, rikthimin në vendin e mëparshëm të punës, si dhe dëmshpërblimet përkatëse për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustifikuar të kontratës individuale të punës, mosrespektimit të procedurës dhe të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, shpërblimin për vjetërsi në punë dhe pagimin e pagës për lejen vjetore të pakryer. Gjykata e rrethit, ka pranuar pjesërisht padinë, duke pranuar kërkimet e kërkueses për dëmshpërblimet e duke rrëzuar pjesën tjetër. Mbi ankimin e palës së paditur, çështja është regjistruar në gjykatën e apelit. Gjatë kohës që çështja ishte në pritje për shqyrtim në Gjykatën e apelit, kërkuesja i është drejtuar dy herë asaj gjykate me kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, nga ku është informuar se çështja është në pritje për t'u planifikuar për gjykim, për shkak se janë ende duke u gjykuar çështje gjyqësore të regjistruara në vitet 2017-2018. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit nga Gjykata e apelit, bazuar në nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Gjykata e Lartë, bazuar në nenin 399/5 të KPC-së, ia ka dërguar kërkesën Gjykatës së apelit, si gjykatës para së cilës pretendohej vonesa. Kjo e fundit, kërkesën, bashkë me informacionin e gjyqtares relatore të çështjes së kërkueses, ia ka dërguar sërish Gjykatës së Lartë, e cila ka vendosur rrëzimin e saj. Në vijim, kërkuesja iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm - Gjykata vërejti se Gjykata e Lartë, në vendimin e kundërshtuar, e ka pranuar tejkalimin e afatit ligjor 2-vjeçar për gjykimin e çështjes në apel, por ka vlerësuar se vonesa nuk i atribuohet sjelljes subjektive të gjyqtares relatore, por pamundësisë objektive të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për shkak të ngarkesës së madhe të krijuar nga akumulimi ndër vite i dosjeve dhe reduktimi i numrit të gjyqtarëve aktivë në sistemin gjyqësor.

Gjykata, duke vërejtur se qëndrimi i Gjykatës së Lartë është mbajtur edhe në çështje të tjera të kësaj natyre, theksoi se ai nuk pajtohet me standardin kushtetues dhe konventor të konsoliduar për të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

Kërkuesja e ka përdorur mjetin e parashikuar nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së, por vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka njohur dhe riparuar shkeljen e pretenduar, ndërsa procedura kryesore në gjykatën e apelit vijon ende. Në këto kushte, për sa kohë nuk ka pasur as konstatim të shkeljes, as përshpejtim real të gjykimit dhe as ndonjë formë tjetër riparimi të përshtatshme, kërkuesja vijon të ruajë statusin e viktimës për qëllime të shqyrtimit kushtetues.

(*vijon në faqen 24)*

Në mosmarrëveshjet e punës, rëndësia e asaj çfarë rrezikon individi nuk varet vetëm nga prova e një gjendjeje ekonomike ekstreme, por edhe nga natyra e marrëdhënies së punës, nga funksioni i saj si burim i të ardhurave dhe nga pasiguria juridike që krijohet për individin kur ligjshmëria e largimit nga puna mbetet për një kohë të gjatë pa përgjigje përfundimtare gjyqësore.

Duke pasur parasysh se, procesi gjyqësor vijon prej më shumë se 5 vjetësh e 5 muajsh, ndërsa vetëm në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm çështja është në pritje për t'u shqyrtuar prej më shumë se 4 vjetësh e 6 muajsh, se vonesa nuk i atribuohet sjelljes së kërkueses, se çështja nuk paraqet kompleksitet të veçantë, si dhe se mosmarrëveshja lidhet me marrëdhënien e punës, Gjykata arriti në përfundimin se në rastin konkret është cenuar e drejta e kërkueses për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës së Lartë, duhet të shfuqizohet, pa e dërguar çështjen për shqyrtim në atë gjykatë.

Vendimmarrja

Gjykata, njëzëri, vendosi pranimin e kërkesës.

Kriteret e legjitimimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual – *Ratione materiae*

FJALË KYÇE

Kontratë shërbimi/ Titull ekzekutiv/ Dëm pasuror/ Lidhje rastësore me shkeljen e konstatuar/ Dëm jopasuror/ GJEDNJ/ Rihapje procesi/ Nenet 6, 13 dhe 41 të KEDNJ-së/ Mjet i veçantë korrigjues

Duke marrë në analizë pretendimet e kërkueses në raport me vendimin e GJEDNJ-së, për pjesën që lidhet me atë, Gjykata çmoi se shqyrtimi i këtyre kërkimeve nuk do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur të saj, për sa kohë që me vendimin e GJEDNJ-së jo vetëm është konstatuar shkelja e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit në Gjykatën e Lartë, por është njohur edhe shpërblimi i dëmit të shkaktuar nga ajo vonesë, çka është edhe qëllimi që ka synuar kërkuesja përmes këtij ankimi kushtetues individual.

Shoqëria "Zyra e Përmbarimit Privat ARB" sh.p.k.

Rihapje e procesit gjyqësor pas vendimit të GJEDNJ-së

Vendimi nr. 65, datë 02.06.2026

Faktet

Kërkuesja, në vitin 2012, pas lidhjes së kontratës së shërbimit me Korporatën Elektroenergjitike të Shqipërisë (KESH), ka filluar procedurën për ekzekutimin e një urdhri ekzekutimi të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në favor të KESH-it. Ajo ka lëshuar urdhrin për vënien e sekuestros konservative mbi llogaritë e debitores, shoqërisë "CEZ Shpërndarje" sh.a., drejtuar bankave të nivelit të dytë.

Në datën 28.05.2014, kërkuesja paditi bankën e nivelit të dytë BKT, me pretendimin se moszbatimi i urdhrit të sekuestros mbi llogarinë e debitores, pengoi ekzekutimin e titullit ekzekutiv dhe i shkaktoi asaj dëm pasuror. Gjykatat e zakonshme e rrëzuan padinë (përkatësisht në vitet 2015 dhe 2016), pasi nuk u vërtetua ekzistenca e dëmit pasuror për efekt të sjelljes së të padituri si dhe pretendimi për moslidhjen e kontratave të mëtejshme me kërkuesen, ishte i pabazuar në ligj.

Në datën 20.05.2016, kërkuesja ka ushtruar rekurs dhe në datën 14.12.2020, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile në fjalë, bazuar në nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

Për këtë vonesë, në datën 21.04.2021, kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual edhe në Gjykatën Kushtetuese, por të dyja gjykatat rrëzuan kërkesat me arsyetimin se vonesat justifikoheshin nga ngarkesa e lartë e dosjeve në Gjykatën e Lartë si dhe rrethanat objektive të çështjes. Kërkuesja i është drejtuar edhe dy herë të tjera Gjykatës Kushtetuese (në vitet 2021 dhe 2024) dhe kërkesa i është rrëzuar. Ndërkohë, Gjykata e Lartë, më datë 27.11.2024, ka gjykuar themelin e çështjes duke vendosur mospranimin e rekursit, të bërë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së.

Pas ankimit të kërkueses në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, u konstatua shkelja e nenit 6 §1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për mosrespektimin e afatit të arsyeshëm të gjykimit dhe GJEDNJ-ja i akordoi kërkueses dëmshpërblim.

Në vijim kërkuesja iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar rihapjen e procesit gjyqësor.

Vlerësimi i Gjykatës

Për legjitimimin e kërkueses - Në këndvështrim të legjitimimit ratione materiae, Gjykata vërejti se kërkuesja ka kërkuar rihapjen e procesit, referuar vendimit të GJEDNJ-së, e cila vendosi se ka pasur shkelje të neneve 6, paragrafi 1, dhe 13 të KEDNJ -së dhe në zbatim të nenit 41 të KEDNJ-së, i ka njohur kërkueses dëmin jopasuror dhe kostot e shpenzimeve (ndërkohë që për dëmin pasuror të pretenduar, nuk ka gjetur ndonjë lidhje rastësore midis saj dhe shkeljeve të konstatuara). Mbi pretendimet e kërkueses në raport me vendimin e GJEDNJ-së, për pjesën që lidhet me atë, Gjykata çmoi se shqyrtimi i këtyre kërkimeve nuk do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur të saj, për sa kohë që me vendimin e GJEDNJ-së jo vetëm është konstatuar

(*vijon në faqen 26)*



shkelja e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit në Gjykatën e Lartë, por është njohur edhe shpërblimi i dëmit të shkaktuar nga ajo vonesë, çka është edhe qëllimi që ka synuar kërkuesja përmes këtij ankimi kushtetues individual.

Masat e propozuara nga GJEDNJ-ja, nuk kanë përmendur ndonjë mjet të veçantë korrigjues, por kanë theksuar në terma të përgjithshëm problematikën ekzistuese, masat e përgjithshme që janë ndërmarrë tashmë dhe që duhet të vijojnë të ndërmerren nga shteti për kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore dhe shkeljen e afatit të arsyeshëm në gjykim.

Për rrjedhojë, Gjykata vlerësoi se kërkuesja nuk legjitimohet për këtë kërkim.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

E drejta e aksesit substancial – Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

Vepër penale/ Bashkëpunëtor/ Provë e re/ Papajtueshmëri faktesh midis vendimeve gjyqësore të formës së prerë/ Rishikim i vendimit gjyqësor/ Mjet i jashtëzakonshëm/ Neni 450 i KPP -së/ Arsyetim ligjor/ Cilësim juridik i veprës penale/ Masa e dënimit

Natyra e jashtëzakonshme e rishikimit dhe karakteri kufizues i shkaqeve të parashikuara nga neni 450 i KPP-së nuk e përjashtonin detyrimin e Gjykatës së Lartë për të shqyrtuar në mënyrë konkrete shkakun e parashtruar nga kërkuesi. Përkundrazi, për sa kohë kërkuesi kishte identifikuar dy vendime të formës së prerë dhe kishte pretenduar se ato mbështeteshin në fakte të papajtueshme, gjykata duhej të verifikonte nëse pretendimi hynte realisht në fushën e zbatimit të shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 450 të KPP-së. Vetëm një verifikim i tillë mund të garantonte që aksesi në mjetin e rishikimit të ishte substancial dhe jo thjesht formal.

Fran Ndreca

Rishikimi i vendimit gjyqësor në lidhje me papajtueshmërinë e fakteve të vëna në themel të një vendimi tjetër të formës së prerë

Vendimi nr. 66, datë 03.06.2026

Faktet

Kërkuesi është identifikuar si bashkëpunëtor i dyshuar në vrasjen e një shtetasi, të ndodhur në vitin 1999, ngjarje për të cilën Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë regjistroi një procedim penal. Bashkëpunëtori tjetër, P.M., i gjykuar në mungesë në shkallë të parë dhe i rigjykuar me rit të shkurtuar u deklarua fajtor për veprat penale të vrasjes me paramendim, të kryer në bashkëpunim dhe armëmbajtjes pa leje, duke u dënuar me 14 vjet burgim. Pas ankimit të prokurorit për masën e dënimit dhe ankimit të shtetasit P.M. për cilësimin juridik të veprës penale, Gjykata e Apelit Tiranë, në 2007, e ka deklaruar fajtor për kryerjen e veprave penale "Vrasja me dashje", në bashkëpunim dhe "Mbajtja pa leje e armëve luftarake", duke e dënuar me 12 vjet heqje lirie.

Ndërkohë, procedimi ndaj kërkuesit u pezullua deri në identifikimin dhe ndalimin e tij në Itali në vitin 2003. Pas rifillimit të procedimit dhe në pritje të ekstradimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e deklaroi fajtor në mungesë për veprën penale të "Vrasjes me paramendim", në bashkëpunim, duke e dënuar me 20 vjet burgim. Sipas asaj gjykate, kërkuesi ka ndihmuar shtetasin P.M. në ekzekutimin e viktimës.

Pas ekstradimit nga Italia, kërkuesit iu rivendos në afat e drejta e ankimit dhe çështja u shqyrtua nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila la në fuqi vendimin e dënimit. Rekursi i tij u shpall i papranueshëm nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë dhe Gjykata refuzoi shqyrtimin e ankimit kushtetues për mosshterim të mjeteve juridike efektive.

Në vitin 2022, kërkuesi kërkoi rishikimin e vendimit penal, duke pretenduar ekzistencën e fakteve të papajtueshme me një vendim tjetër të formës së prerë dhe zbulimin e provave të reja. Kërkesa u shpall e papranueshme nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim që u la në fuqi nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Në vijim, kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e ankimit substancial dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor - Gjykata çmoi se megjithëse Gjykata e Lartë e ka identifikuar në mënyrë të drejtë në plan abstrakt kuptimin e papajtueshmërisë faktike, ajo nuk e ka zbatuar këtë standard në mënyrë të plotë ndaj rrethanave konkrete të çështjes. Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale nga "Vrasja me paramendim" në "Vrasja me dashje", nuk përbën vetëm një interpretim të ndryshëm juridik të së njëjtës situatë. Ato lidhen me fakte historike që kanë të bëjnë me origjinën dhe natyrën e konfliktit, zhvillimin e tij në kohë dhe ekzistencën ose jo të një vendimi paraprak për kryerjen e vrasjes dhe duhet të krahasoheshin konkretisht me faktet e vëna në themel të vendimit të dënimit të kërkuesit për vrasje me paramendim, të kryer në bashkëpunim.

Në veçanti, duhej të vlerësohej nëse situata faktike e pranuar nga gjykata e apelit për spontanitetin e konfliktit dhe mungesën e paramendimit

(*vijon në faqen 28)*



ishte e pajtueshme me ekzistencën e një plani ose vendimi të përbashkët paraprak, mbi të cilin ishte mbështetur fajësia e kërkuesit.

Duke pasur parasysh funksionin e rishikimit për korrigjimin e gabimeve që mund të qëndrojnë në themel të një vendimi penal të formës së prerë, Gjykata e Lartë kishte detyrimin të shqyrtonte në mënyrë konkrete dhe të plotë pretendimin e kërkuesit. Ajo duhej të identifikonte vendimmarrjen përfundimtare për P.M., të veçonte faktet përcaktuese të pranuara në të dhe t'i krahasonte ato me faktet mbi të cilat ishte mbështetur dënimi i kërkuesit. Mungesa e këtij verifikimi e lë të pambështetur përfundimin se të dyja vendimet nuk përmbanin papajtueshmëri faktesh, pasi nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë shqyrtuar rrethanat faktike mbi të cilat ishte bazuar ndryshimi i vendimit për P.M. dhe rëndësinë e mundshme të tyre për themelin e fajësisë së kërkuesit. Në këto kushte, përgjigjja e dhënë nga ajo gjykatë nuk përmbush kërkesën për një shqyrtim konkret dhe efektiv të shkakut të rishikimit.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin pjesërisht të kërkesës (një gjyqtar është shprehur me mendim pakice).

Parimi i prezumimit të pafajësisë

Skënder Krasniqi

Deklarimi fajtor pa u mbështetur në prova të mjaftueshme

Vendimi nr. 67, datë 03.06.2026

FJALË KYÇE

Dënim me burgim për vrasje me paramendim/ Pushimi i ndjekjes penale/ Pezullimi i hetimeve/ Rifillimi i hetimeve/ Deklarime të dhëna përpara policisë/ Transkriptimi i përgjimeve ambientale / Prova shkencore/ Krahasim daktiloskopik i gjurmëve të gjetura në vendngjarje/ Dëshmi kontradiktore/ Mungesa e provave të drejtpërdrejta/ Ekzistenca e motivit të dobët/ Kërkesë për ritranskriptim të përgjimeve

Faktet

Kërkuesi është proceduar penalisht për vrasjen me paramendim të një shtetasi të moshës 82 vjeç. Në mungesë të provave të drejtpërdrejta, prokuroria fillimisht ka vendosur pushimin e ndjekjes penale ndaj kërkuesit. Po kështu, ajo ka pezulluar edhe hetimin e ngjarjes për shkak të pamundësisë së identifikimit të autorit. Pas ankimit të trashëgimtarëve të viktimës, gjykata ka urdhëruar rifillimin e hetimeve. Me rifillimin e hetimeve, prokuroria ka urdhëruar, ndër të tjera, ritranskriptimin e përgjimeve ambientale. Në përfundim të gjykimit në shkallë të parë, Gjykata e Fierit e ka dënuar kërkuesin me 20 vjet burgim. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit. Në vijim, kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë - Gjykata vërejti se, kërkuesi ka vënë në dyshim mënyrën e vlerësimit të provave, ndaj analizoi nëse fajësia ishte rrjedhojë e prezumimeve të faktit që tejkalojnë kufijtë e arsyeshëm ose që ka cenuar të drejtat e mbrojtjes. Gjykata konstatoi se gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar mbi ekzistencën e motivit të dobët duke rindërtuar me hollësi mekanizmin e kryerjes së veprës penale dhe veprimet konkrete të kërkuesit, pa analizuar ndonjë provë të drejtpërdrejtë ose rrethanore për këtë qëllim. Ato janë mbështetur në transkriptimin e përgjimit ambiental të zhvilluar ndërmjet kërkuesit dhe nënës së tij, përmbajtja e të cilit vetëm pas rifillimit të hetimeve, 5 vite pas ngjarjes, u interpretua si element që mbështeste në mënyrë të tërthortë autorësinë e vrasjes. Kurse kërkesa e mbrojtjes që ritranskriptimi të kryhej nga një grup specialistësh, me qëllim verifikimin e besueshmërisë së këtij elementi provues, u refuzua si e panevojshme. Gjykata çmoi se mënyra se si gjykatat kanë vlerësuar fajësinë e kërkuesit ka cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë, pasi është ndërtuar mbi prezumime fakti dhe refuzimi i kërkesës për verifikimin e besueshmërisë së elementit provues ka cenuar të drejtat e mbrojtjes. Duke qenë se riparimi i shkeljes kërkon rivlerësimin e fakteve dhe të provave të administruara gjatë hetimit, rihetimit dhe gjykimit, çështja duhet të rishqyrtohet nga gjykata e apelit.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e pjesshëm të kërkesës.

Prezumimet ligjore ose të faktit duhet të qëndrojnë brenda kufijve të arsyeshëm dhe të mos cenojnë të drejtat e mbrojtjes.

Mënyra e vlerësimit të provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm si pasojë e të cilës janë cenuar garancitë kushtetuese për t'u prezumuar i pafajshëm i nënshtrohet kontrollit kushtetues.

Proces i rregullt ligjor - Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

Diana Kademi dhe Sutë Kademi

Mospajisja me dokumentacion dhe kartela pasurie nga ZVRPP-ja (ASHK-ja)

Vendimi nr. 68, datë 04.06.2026

FJALË KYÇE

Trashëgimi ligjore/ Pajisje me dokumentacion/ Dhënie informacioni/ ZVRPP (ASHK)/ Shtesë rekursi/ Arsyetim vendimi

Faktet

Kërkueset që prej vitit 2008 i janë drejtuar vazhdimisht Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) me kërkesë për pajisjen me kopje të dokumentacionit të dy pasurive (truall dhe banesë), të fituara, sipas tyre, me trashëgimi ligjore, si dhe pajisjen me kartelat dhe hartat treguese të pasurive, ndërsa kanë marrë përgjigje se pronat figuronin të regjistruara në emër të personave të tjerë. Në këtë situatë, ato i janë drejtuar gjykatës që të detyrojë ZVRPP-në t'u vërë në dispozicion dhe t'i pajisë me dokumentacionin e kërkuar.

Gjykata e Shkallës së Parë ka rrëzuar kërkesëpadinë, me arsyetimin se ZVRPP-ja kishte vënë në dispozicion të kërkueseve dhe paraqitur edhe në gjykim aktet e dokumentet që pasqyronin ndryshimet në sipërfaqen dhe të drejtat e pronësisë për pasuritë në fjalë, ndërsa pretendimet e kërkueseve për titujt e pronësisë të personave të tretë ishin rrëzuar në një proces tjetër gjyqësor, me vendim të formës së prerë, ndaj kërkimi që ZVRPP-ja t'i pajiste me kartelën dhe hartën treguese të pasurisë ishte i pabazuar. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit. Mbi rekursin e shtesën e rekursit të paraqitur nga kërkueset, në të cilën kanë parashtruar, ndër të tjera, se arsyetimi i gjykatës së apelit binte ndesh me vendimin njësues nr. 216/2018, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, Gjykata e Lartë, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se shkaqet e ngritura nuk parashikoheshin nga ligji. Në vijim kërkueset iu drejtuan Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, nga pikëpamja kushtetuese, përveçse kur shkelja është thelbësore.

Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ishte detyrë e kërkueseve t'i parashtronin shkaqet qartësisht dhe t'i argumentonin pretendimet për zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural ose rëndësinë themelore të shkeljes në kuadër të njësimit ose zhvillimit të praktikës gjyqësore.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor -

Gjykata, ndërsa konstatoi se në arsyetimin e Gjykatës së Lartë nuk është evidentuar paraqitja e shtesës së rekursit dhe vlerësimi për të, verifikoi nëse në këtë akt kërkueset kishin parashtruar shkaqe të reja dhe nëse mungesa e evidentimit të shtesës së rekursit në vendimin e Gjykatës së Lartë ka vënë në dyshim thelbin e vendimmarrjes së kësaj gjykate dhe standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjykata vlerësoi se mospasqyrimi në vendim i pretendimeve të parashtruara në shtesën e rekursit nuk ka ndikuar në thelbin e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, për sa kohë që vendimi nr. 216/2018, i kësaj të fundit nuk ishte njësues, ndërsa argumentet e paraqitura në shtesën e rekursit përbënin në thelb përsëritje të pretendimeve të ngritura më parë gjatë gjykimit në gjykatat e zakonshme dhe në rekurs. Gjykata vlerësoi se Gjykata e Lartë e ka analizuar çështjen edhe në raport me respektimin nga gjykatat e faktit të vendimeve njësuese, ndaj kërkueset kanë marrë përgjigje për pretendimet e parashtruara në këtë drejtim. Në këtë mënyrë, mospasqyrimi në vendimin e Gjykatës së Lartë i pretendimeve të ngritura nga kërkueset në shtesën e rekursit nuk përbën shkelje thelbësore, ndaj pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

E drejta e aksesit – Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

Renisa Selenica

Nxjerrja jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar e kërkimit për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore

Vendimi nr. 69, datë 04.06.2026

FJALË KYÇE

Interesi më i lartë i fëmijës/ Përgjegjësia prindërore/ Mungesë juridiksioni/ Konventa për të drejtat e fëmijës/ Konventa për përgjegjësinë prindërore/ Zgjidhje e martesës/ Hierarkia e akteve

Ndonëse objekt i shqyrtimit në rastin konkret nuk është mënyra e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, por përcaktimi i juridiksionit për shqyrtimin e këtij kërkimi, analiza duhet të mbajë parasysh edhe parimin e interesit më të lartë të fëmijës, të garantuar nga neni 54 i Kushtetutës dhe të reflektuar në legjislacionin e brendshëm dhe në instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme. Në çështjet familjare me elemente të huaja, ky parim nuk vepron si kriter autonom dhe as mund të zbatohet i shkëputur nga rregullat e juridiksionit që përcaktojnë autoritetin kompetent.

Faktet

Kërkueses dhe shtetasit belg S.S nga martesa e lidhur mes tyre në vitin 2020, u ka lindur një fëmijë në Belgjikë, shtet në të cilin ata kanë bashkëjetuar deri në korrik të vitit 2022, kur udhëtuan për në Shqipëri me pushime. Si pasojë e mosmarrëveshjeve mes tyre, kërkuesja nuk u kthye në Belgjikë, regjistroi fëmijën në Shqipëri me shtetësi shqiptare dhe nisi procesin gjyqësor për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj. Një proces i njëjtë u nis dhe nga bashkëshorti në Belgjikë, i cili kërkoi njëkohësisht dhe kthimin e fëmijës në Belgjikë. Në vijim autoritetet belge, nëpërmjet kërkesës drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, bazuar dhe në vendimmarrjen e gjykatave belge, të cilat kishin konkluduar se kërkuesja kishte shkelur dispozitat e Konventës së Hagës "Mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës" kërkuan kthimin e fëmijës në vendbanimin e përhershëm në Belgjikë. Megjithëse gjykatat shqiptare vendosën përfundimisht detyrimin për kthimin e fëmijës, kërkuesja nuk zbatoi vendimet gjyqësore dhe kërkoi disa herë pezullimin e ekzekutimit të kthimit të fëmijës. Në procesin për zgjidhjen e martesës dhe pasojave të saj, gjykatat belge kanë pranuar zgjidhjen e martesës dhe i kanë njohur shtetasit S.S përkohësisht të drejtën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe qëndrimin e fëmijës me të në Belgjikë. Gjithashtu dhe procesi gjyqësor i zhvilluar në Shqipëri ka pranuar zgjidhjen e martesës, kurse për sa i përket pasojave të saj lidhur me fëmijën, gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë, S.S kërkoi nxjerrjen jashtë juridiksionit shqiptar, kërkesë që u pranua nga gjykata. Mbi rekursin e veçantë të kërkueses për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar të çështjes së përcaktimit të përgjegjësisë prindërore, si dhe kundërrekursit të shtetasit S.S., Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Në vijim kërkuesja iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor – Në lidhje me pretendimin e kërkueses se qëndrimi faktik i fëmijës në Shqipëri, shtetësia shqiptare dhe regjistrimi i tij në këtë shtet ishin përcaktues për juridiksionin gjyqësor shqiptar, Gjykata vlerësoi se në arsyetimin e Gjykatës së Lartë nuk ka ndonjë gabim ligjor ose faktik të dukshëm dhe as nuk e bën haptazi arbitrar përfundimin e saj se këto rrethana ishin të pamjaftueshme për përcaktimin e juridiksionit të gjykatave shqiptare. Kjo, pasi kohëzgjatja e qëndrimit të fëmijës në Shqipëri duhet të vlerësohet në raport me nenin 7, të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore dhe rrethanat konkrete të çështjes, ku kjo kohëzgjatje faktike e qëndrimit të fëmijës në Shqipëri lidhet me pasojat e një situate të vlerësuar gjyqësisht si mbajtje pa të drejtë e fëmijës dhe të zgjatur për shkak të mosekzekutimit në kohë të vendimit nga kërkuesja për kthimin e fëmijës në vendqëndrimin e zakonshëm në Belgjikë.

Gjithashtu, Gjykata vlerësoi se edhe sa i përket pretendimit të kërkueses se juridiksioni i pranuar për zgjidhjen e martesës duhej të sillte domosdoshmërisht edhe juridiksionin për kërkimin që lidhet me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë

(*vijon në faqen 32)*

Kontrolli kushtetues në rastin konkret nuk konsiston në rivlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës në raport me mënyrën konkrete të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, por në verifikimin nëse gjykatat e zakonshme kanë identifikuar, interpretuar dhe zbatuar pa arbitraritet rregullat e juridiksionit, në një mënyrë të pajtueshme me parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

prindërore nuk gjen mbështetje në nenin 10 të Konventës, për sa kohë kjo dispozitë kërkon pranimin nga prindërit të juridiksionit për marrjen e masave në lidhje me mbrojtjen e fëmijës, juridiksion ky i cili pushon me përfundimin e procedurës së divorcit. Pas këtij momenti vetëm autoriteti që ka juridiksion sipas neneve 5-9 të konventës mund të vendosë për këto masa.

Për sa i përket pretendimit të kërkueses për nenin 13 të Konventës për Përgjegjësinë Prindërore, Gjykata mban parasysh se ky nen nuk vendos një rregull përparësie formale në favor të autoritetit që është vënë i pari në lëvizje, pavarësisht nëse ai ka juridiksion sipas konventës. Kjo dispozitë vepron në rastet kur masat korresponduese janë kërkuar përpara autoriteteve të një shteti tjetër kontraktues që kanë juridiksion sipas neneve 5-10 të konventës dhe janë ende në shqyrtim. Në këtë kuptim, pretendimi i kërkueses se procedura ishte nisur më parë përpara gjykatës shqiptare nuk mjafton, në vetvete, për ta bërë haptazi arbitrar përfundimin e Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, mungesa e një analize të veçantë për nenin 13 nuk evidenton një mangësi të tillë në arsyetimin e Gjykatës së Lartë që ta bëjë atë të pamjaftueshëm ose përfundimin e saj haptazi arbitrar, për sa kohë ajo ka dhënë arsye për mungesën e juridiksionit shqiptar në raport me rregullat e Konventës për Përgjegjësinë Prindërore të cilat i ka konsideruar përcaktuese. Në përfundim, Gjykata vlerëson se vendimmarrjet e kundërshtuara nuk paraqesin gabime ligjore ose faktike të dukshme, paqartësi ose elemente arbitrariteti të një shkalle të tillë sa të cenojnë këtë të drejtë të pretenduar nga kërkuesja.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (një gjyqtare u shpreh me mendim pakice).

Pushimi i gjykimit të çështjes - Parimi i disponibilitetit

Enkeleda Kapedani

Heqje dorë nga kërkesa dhe pushimi i gjykimit të çështjes

Vendimi nr. 71, datë 11.06.2026

FJALË KYÇE

Veprime hetimore/ Person pa pozitë procedurale në procedim penal/ Kontroll banese/ Sekuestrim pajisjesh elektronike

Faktet

Kërkuesja ka ushtruar funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan deri më 18.05.2022. Më pas ajo u përfshi në veprime hetimore të zhvilluara në kuadër të një procedimi penal të regjistruar nga Prokuroria e Posaçme në vitin 2023, ndonëse nuk kishte asnjë pozitë procedurale në atë procedim penal. Me vendim të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO-ja e së Shkallës së Parë) u lejua kontrolli i banesës së saj, gjatë të cilit u sekuestruan disa pajisje elektronike dhe një dokument, vendim gjyqësor.

Kërkuesja kundërshtoi fillimisht vendimin që autorizoi kontrollin e banesës, por ankimi dhe më pas rekursi i saj u shpallën të papranueshëm. Më tej, ajo kërkoi heqjen e sekuestros dhe kthimin e sendeve të sekuestruara, kërkesë e cila u rrëzua nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, vendim i miratuar nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO-ja e Apelit), ndërsa rekursi në Gjykatën e Lartë nuk u pranua.

Për rrjedhojë, kërkuesja paraqiti dy kërkesa në Gjykatën Kushtetuese: një për kundërshtimin e vendimeve që lejuan kontrollin e banesës dhe një tjetër për kundërshtimin e vendimeve që refuzuan heqjen e sekuestros dhe kthimin e sendeve. Të dyja çështjet u kaluan për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh dhe, për shkak të lidhjes mes tyre, u bashkuan në një proces të vetëm.

Në datën 10.06.2026, kërkuesja hoqi dorë nga kërkesa dhe kërkoi pushimin e gjykimit.

Gjykata vlerësoi se nuk ka arsye bindëse për vazhdimin e gjykimit për shkak të një interesi publik, pasi pretendimet e kërkueses janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me cenimin e interesave të saj kushtetues dhe në këto rrethana nuk ka vend për të zbatuar përjashtimin nga parimi i disponibilitetit.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vërejti se, një ditë përpara shqyrtimit të çështjes në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, kërkuesja ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga kërkesa dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Neni 31/b, i Ligjit Organik të Gjykatës parashikon të drejtën e kërkuesit për të hequr dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata, e cila në këtë rast vendos pushimin e gjykimit të çështjes, përveçse kur vlerëson se shqyrtimi i saj paraqet interes publik. Pika 2, e nenit 43/b, të po këtij ligji, ia njeh këtë të drejtë kërkuesit në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata.

Mbi bazën e këtij kuadri normativ, Gjykata vlerësoi se nuk ka arsye bindëse për vazhdimin e gjykimit për shkak të një interesi publik, pasi pretendimet e kërkueses janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me cenimin e interesave të saj kushtetues dhe në këto rrethana nuk ka vend për të zbatuar përjashtimin nga parimi i disponibilitetit. Për pasojë, gjykimi i çështjes duhet të pushohet, bazuar në nenin

31/b, të Ligjit Organik të Gjykatës.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pushimin e gjykimit të çështjes.

E drejta e aksesit substancial -Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

Zymer Martinaj, Diana Martinaj

Mospërmbushja e detyrimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen e jetës

Vendimi nr. 72, datë 16.06.2026

FJALË KYÇE

Aksident automobilistik/ Zonë ushtarake/ Mungesë e sinjalistikës ndaluese të mjeteve civile/ Veprimtari e palejuar/ Ekspertimi autoteknik/ Pushim procedimi penal/ Përgjegjësi jashtëkontraktore/ Neglizhencë e autoriteteve shtetërore/ Dëmshpërblim pasuror dhe jopasuror

Jeta e personit mbrohet me ligj dhe kur humbja e jetës ka ardhur si pasojë e neglizhencës së autoriteteve shtetërore, shteti ka detyrimin të ndërmarrë masa efektive për të sqaruar rrethanat e ngjarjes, për të identifikuar përgjegjësit dhe për të siguruar dëmshpërblimin e përshtatshëm për viktimën ose familjarët e saj.

Faktet

Kërkuesit janë bashkëshortë dhe trashëgimtarë ligjorë të djalit të tyre, i cili ka humbur jetën si pasojë e një aksidenti, të ndodhur në pistën e fushës së aviacionit ushtarak të Gjadrit. Prokuroria ka hetuar ngjarjen dhe ka vendosur pushimin e procedimit penal ndaj drejtuesit të automjetit duke e konsideruar si rast fatkeq. Kërkuesit kanë kërkuar dëmshpërblim për ngjarjen nga Ministria e Mbrojtjes dhe Komanda e Forcës Ajrore me pretendimin se humbja e jetës ka ardhur si pasojë e mosmarrjes së masave të nevojshme për ruajtjen dhe administrimin e zonës ushtarake. Gjykata e Lezhës ka vendosur rrëzimin e padisë me argumentin, ndër të tjera, se nuk ishte provuar fajësia e institucioneve shtetërore për ngjarjen. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve si të pabazuar në ligj. Në vijim, kërkuesit iu drejtuan Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit - Gjykata vërejti se pretendimet e kërkuesve lidhen me mosveprimet e autoriteteve shtetërore përgjegjëse për administrimin e fushës së ish-aviacionit ushtarak, ndaj ajo verifikoi nëse përgjigjja e gjykatave të zakonshme përmbushte standardet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor.

Gjykata konstatoi se gjykatat e faktit nuk kanë sqaruar rrethanat vendimtare të çështjes, konkretisht statusin juridik të zonës ku ndodhi aksidenti, autoritetin përgjegjës për administrimin e saj, natyrën e masave që kërkoheshin për kontrollin, ruajtjen dhe kufizimin e hyrjes në atë territor, si dhe masat që rezultonin të ishin marrë realisht përpara aksidentit, por e kanë reduktuar shqyrtimin në një vlerësim formal të elementeve të përgjegjësisë jashtëkontraktore. Ato i kanë dhënë rëndësi faktit se prokuroria e kishte cilësuar ngjarjen si rast fatkeq dhe se nuk kishte regjistruar procedim penal ndaj autoriteteve shtetërore përgjegjëse për administrimin e territorit ku ndodhi aksidenti. Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur qëndrim të shprehur ndaj këtyre çështjeve. Gjykata çmoi se gjykatat e zakonshme nuk kishin shqyrtuar mjaftueshëm nëse autoritetet publike kishin përmbushur detyrimet ligjore për administrimin, ruajtjen dhe kontrollin e territorit ku ndodhi aksidenti, në këndvështrimin e së drejtës kushtetuese për mbrojtjen e jetës dhe të detyrimeve pozitive të shtetit që burojnë nga kjo e drejtë, ndaj vendimmarrja nuk përmbush standardet kushtetuese në drejtim të aksesit substancial në gjykatë dhe të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e pjesshëm të kërkesës.

E drejta e aksesit substancial në gjykatë e lidhur me të drejtën për mjet juridik efektiv – Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor – E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

FJALË KYÇE

Autoriteti i Aviacionit Civil/ Marrëdhënie pune/ Shërbimi civil/ Kodi i punës/ Moskompetencë lëndore/Vendim i ndërmjetëm/ Disponibilitet i padisë

Ligji i zbatueshëm për marrëdhënien e kërkueses dhe pasojat e hyrjes në fuqi të ligjit të ri të AAC-së mbi statusin e saj përbënin çështje të kontestuara në themelin e padisë. Në këto kushte, për sa kohë përfundimi se marrëdhënia e kërkueses rregullohej nga Kodi i Punës dhe se mosmarrëveshja kishte natyrë civile lidhej drejtpërdrejt me çështje të kontestuara në themelin e padisë, Gjykata e Lartë duhej të arsyetonte përse ky vlerësim mund të bëhej në fazën e përcaktimit të kompetencës lëndore, pa paragjykuar shqyrtimin në themel të pretendimeve të kërkueses për statusin e nëpunëses civile dhe për ligjshmërinë e akteve të kundërshtuara.

Stela Ulqinaku

Përcaktimi i kompetencës lëndore nga Gjykata e Lartë

Vendimi nr. 73, datë 16.06.2026

Faktet

Kërkuesja ka qenë e punësuar pranë Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC) prej vitit 2015, me status të nëpunësit civil. Pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil", AAC-ja doli nga regjimi i shërbimit civil dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të saj iu nënshtruan Kodit të Punës.

Në vitin 2023, me riorganizimin e strukturës dhe urdhër të drejtorit ekzekutiv të AAC-së, kërkuesja është liruar nga pozicioni drejtore drejtorie, për t'u emëruar si përgjegjëse sektori në të njëjtën drejtori. Pas refuzimit të saj për pozicionin, AAC-ja ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe financiare me kërkuesen.

Me pretendimin se gëzonte ende statusin e nëpunëses civile sipas ligjit nr. 152/2013, dhe se largimi ishte kryer në kundërshtim me këtë regjim juridik, kërkuesja iu drejtua gjykatës me kërkesëpadi për shfuqizimin e akteve administrative, rikthimin në detyrë dhe pagimin e pagës mujore që kishte në momentin e largimit, nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, shpalli moskompetencën lëndore, duke vlerësuar se mosmarrëveshja kishte natyrë civile dhe ia kaloi çështjen Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë. Kjo e fundit, iu drejtua Gjykatës së Lartë për rregullimin e kompetencës lëndore sipas nenit 64 të Kodit të Procedurës Civile.

Me vendim të Kolegjit Civil, Gjykata e Lartë përcaktoi si gjykatë kompetente Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke arsyetuar se, për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit të ri të AAC-së, marrëdhënia juridike e kërkueses nuk i përkiste më regjimit të shërbimit civil, por ishte një marrëdhënie pune e rregulluar nga Kodi i Punës, çka i jepte mosmarrëveshjes natyrë civile. Në vijim, kërkuesja iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.

Vlerësimi i Gjykatës

Për kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive - Gjykata vërejti se, në aspektin formal, objekt i ankimit kushtetues individual është një vendim gjyqësor i ndërmjetëm, që nuk e ka zgjidhur në themel çështjen, por ka përcaktuar gjykatën që ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e saj. Megjithatë, Gjykata çmoi se, në rastin konkret, vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë konsiderohet përfundimtar për qëllime të kontrollit kushtetues, pasi, ndonëse nuk ka zgjidhur themelin e mosmarrëveshjes, përmbush kriteret që lejojnë, në mënyrë përjashtimore, ushtrimin e kontrollit kushtetues ndaj një vendimi të ndërmjetëm. Për rrjedhojë, kërkuesja legjitimohet në drejtim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive.

Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial në gjykatë të lidhur me të drejtën për mjet juridik efektiv - Gjykata çmoi të theksojë se mjeti gjyqësor është efektiv kur gjykata përkatëse është në gjendje të shqyrtojë në substancë pretendimet thelbësore

(*vijon në faqen 36)*

Në analizën e saj nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë marrë në konsideratë parimin e disponibilitetit të padisë dhe përfundimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara në vendimin nr. 3/2012, për sa i përket identifikimit të shkakut të padisë, rolit të paditësit në përcaktimin e mbrojtjes gjyqësore që kërkon dhe pasojave që rrjedhin kur gjykata vlerëson nëse kërkimi i paraqitur gëzon ose jo mbrojtje ligjore në themel.

të palës dhe të japë një përgjigje të arsyetuar mbi to. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë nuk ka sqaruar nëse gjykata civile, si gjykata e përcaktuar kompetente, mund t'u japë përgjigje pretendimeve për ligjshmërinë e akteve që kërkuesja i lidh me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, ruajtjen e statusit të nëpunëses civile dhe pasojat që rrjedhin prej tij. Për rrjedhojë, vetëm fakti se çështja vijon pranë gjykatës civile nuk mjafton, në rrethanat e rastit konkret, për të përjashtuar cenimin e aksesit substancial në gjykatë dhe të së drejtës për mjet juridik efektiv.

Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor - Gjykata çmoi se cenimi i së drejtës së kërkueses qëndron në faktin se arsyetimi i përdorur nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar përfundimin se natyra e mosmarrëveshjes, siç ishte parashtruar nga kërkuesja, aktet e kundërshtuara, kërkimet konkrete të padisë dhe statusi i pretenduar i nëpunëses civile nuk ishin përcaktuese për kompetencën lëndore. Në veçanti, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar nëse dhe përse çështja e ligjit të zbatueshëm për marrëdhënien e kërkueses, e cila ishte një nga çështjet thelbësore të padisë, mund të zgjidhej në fazën e rregullimit të kompetencës pa cenuar mundësinë e kërkueses për shqyrtimin në themel të pretendimeve të saj. Duke mos dhënë përgjigje për këto elemente, Gjykata e Lartë ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor në atë masë, që ky standard lidhet me garantimin e aksesit substancial në gjykatë dhe të mjetit juridik efektiv.

Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj- Për sa kohë Gjykata nuk përcakton vetë gjykatën kompetente dhe nuk zgjidh natyrën civile ose administrative të mosmarrëveshjes, ky pretendim nuk mund të marrë përgjigje të pavarur në këtë gjykim kushtetues. Ai duhet të shqyrtohet dhe të marrë përgjigje nga Gjykata e Lartë, në përmbushje të detyrimit të saj për të arsyetuar mbi kompetencën lëndore, duke mbajtur parasysh natyrën e akteve të kundërshtuara, statusin e pretenduar nga kërkuesja, kërkimet kryesore të padisë dhe kriteret e nenit 7 të Ligjit për Gjykatat Administrative.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës.

E drejta e aksesit substancial lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor – E drejta e mosdënimit pa ligj – Parimi i prezumimit të pafajësisë – E drejta e mbrojtjes – Parimi i barazisë së armëve

FJALË KYÇE

Shpërdorim i detyrës/ masë administrative e largimit nga detyra / moskallëzim i krimit/ "Arresti në burg"/ azil politik/ statusi i sinjalizuesit/ trafikimi i lëndëve narkotike/ veprimtari të dyshuara kriminale/ denoncim i funksionarëve të lartë publikë

Argumentimi se pretendimet e kërkuesit kishin marrë përgjigje nga gjykata e apelit nuk përjashton Gjykatën e Lartë nga detyrimi për të verifikuar nëse përgjigjet ishin në përputhje me standardet kushtetuese. Referimi i përgjithshëm tek arsyetimi i gjykatës së apelit, pa identifikuar pretendimet kushtetuese dhe pa shpjeguar përse ato nuk përbënin shkaqe rekursi, nuk përmbush funksionin kushtetues të saj.

Shqyrtimi *de plano* nuk mund të reduktohet në një formalitet procedural, veçanërisht kur rekursi ngre çështje që lidhen drejtpërdrejt me ligjshmërinë e dënimit penal dhe me respektimin e garancive themelore të procesit.

Dritan Zagani

Qartësimi i cilësimit juridik të fakteve dhe mungesa e arsyetimit mbi fajësinë e kërkuesit nga Gjykata e Lartë

Vendimi nr. 74, datë 16.06.2026

Faktet

Kërkuesi ka ushtruar detyrën e shefit të seksionit për narkotikët në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier. Fillimisht u procedua administrativisht dhe iu dha masa e largimi nga detyra, me argumentin se kishte kryer veprime të paautorizuara nga eprorët dhe të palejuara nga ligji. Njëkohësisht u procedua penalisht për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 248 dhe 300 të Kodit Penal (KP) dhe gjatë kohës që ishte nën masën e sigurimit "Arrest në shtëpi", u largua jashtë Shqipërisë dhe sipas tij mori statusin e azilkërkuesit në Zvicër. Në përfundim të gjykimit u deklarua fajtor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, sipas akuzës dhe u dënua me 4 vjet e 6 muaj burgim, vendim ky që u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi mospranimim e rekursit të kërkuesit. Në vijim, kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor – Lidhur me pretendimet e kërkuesit, Gjykata vëren se argumentet e paraqitura prej tij, në thelb, nuk synojnë vetëm një rivlerësim të provave ose një interpretim të ndryshëm të ligjit të zakonshëm, por ato lidhen me respektimin e *së drejtës së mosdënimit pa ligj, parimin e prezumimit të pafajësisë, të drejtën e mbrojtjes dhe parimin e barazisë së armëve.* Gjykata e Lartë duhej të shpjegonte arsyet se pse nuk lidhej me të drejtën kushtetuese të mosdënimit pa ligj pretendimi për mungesën e identifikimit të normës konkrete të shkelur në raport me përgjegjësinë hierarkike për sa u takon komunikimeve me eprorët për ndjekjen e ngjarjes kriminale, si dhe pse veprimet me informatorin nuk përbënin krim, por kundërvajtje penale. Ajo gjykatë duhej të arsyetonte përse pretendimet për mungesën e ekzistencës së pasojës konkrete dhe lidhjes shkakësore ndërmjet sjelljes dhe pasojës nuk ngrinin çështje që lidheshin me parimin e prezumimit të pafajësisë, si dhe duhet të argumentonte se përse nuk lidhej me të drejtën e mbrojtjes dhe parimin e barazisë së armëve pretendimi për mosmarrjen në konsideratë të provave shfajësuese që lidheshin me rolin dhe kontributin e tij në parandalimin e kriminalitetit. Gjithashtu, pretendimi i kërkuesit se ka vepruar në kontekstin e zhvillimeve politike të tilla, që më pas rezultuan me shkarkimin dhe dënimin e një funksionari të lartë publik, ishte i tillë që kërkonte një vlerësim të kujdesshëm nga Gjykata e Lartë, me qëllim garantimin e besimit publik te sistemi i drejtësisë, për aq sa ky pretendim lidhej me të drejtën e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme dhe parimin e prezumimit të pafajësisë. Gjykata nuk paragjykon mënyrën se si Gjykata e Lartë duhet t'u përgjigjet në themel pretendimeve të ngritura. Detyra e juridiksionit kushtetues kufizohet në verifikimin nëse kërkuesit i është garantuar një shqyrtim real dhe një përgjigje e arsyetuar ndaj pretendimeve të tij me natyrë kushtetuese.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e pjesshëm të kërkesës.

E drejta e aksesit – Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

Razije Hoxholli

Afati i parashkrimit të padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor

Vendimi nr. 75, datë 18.06.2026

FJALË KYÇE

Aksident automobilistik/ Shkelja e rregullave të qarkullimit/ Dëm pasuror dhe jopasuror/ Shoqëri sigurimi/ BSHS/ Dëmshpërblim/ Afat 3-vjeçar/ Parashkrim i së drejtës/ Kërkesëpadi jashtë afatit ligjor/ Neni 115, shkronja "dh", i KC-së.

Faktet

Kërkuesja, ka pësuar një aksident automobilistik në vitin 2008, për të cilin Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan regjistroi procedimin penal dhe nisi hetimet ndaj drejtuesit të mjetit, shtetasit E.Xh., shkaktar të aksidentit. Nga ekspertimi mjeko-ligjor rezultoi plagosje e rëndë e kërkueses, ndërsa ekspertimi auto-teknik përcaktoi se aksidenti ishte shkaktuar nga shkelja e rregullave të qarkullimit nga ana e drejtuesit të mjetit. Në datën 20.11.2009, çështja është dërguar për gjykim dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, deklaroi fajtor shtetasin E.Xh. Ky vendim u konfirmua nga Gjykata e Apelit Durrës, në 2012.

Më 11.11.2013, kërkuesja paraqiti kërkesë për dëmshpërblim pranë shoqërisë së sigurimit. Për shkak të paqartësive mbi siguruesin, kërkesa u shqyrtua nga Byroja Shqiptare e Sigurimit (BSHS), e cila e refuzoi atë, si të paraqitur jashtë afatit ligjor.

Në 11.09.2014, kërkuesja dhe familjarët e saj iu drejtuan Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi për shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror si rezultat i dëmtimeve shëndetësore të pësuara nga kërkuesja në aksident. Ajo gjykatë e rrëzoi padinë, duke vlerësuar se ishte paraqitur tej afatit ligjor trevjeçar të parashikuar nga neni 115, shkronja "dh", i Kodit Civil. Vendimi u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me të njëjtin arsyetim, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vendosi mospranimin e rekursit të kërkueses, me arsyetimin se nuk ekzistonin shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile. Në vijim, kërkuesja iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Përgjigjja që kanë dhënë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për pretendimin se paraqitja e padisë civile kushtëzohej nga vendimi penal i formës së prerë, është e plotë dhe e qartë, sepse analizon se konkurrimi i përgjegjësisë penale për autorin, nuk e pengon atë në kërkimin e shpërblimit të dëmit në rrugë civile.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor – Gjykata vlerësoi se kërkuesja, në cilësinë e të dëmtuarës nga vepra penale, kishte dijeni për autorin që i ka shkaktuar dëmin ndaj shëndetit, të paktën që nga momenti që çështja është dërguar për gjykim, pra në datën 20.11.2009, dhe për rrjedhojë, nga ky moment fillon të llogaritet edhe afati i parashkrimit të padisë, e cila duhet të ishte paraqitur deri në datën 19.11.2012.

Gjykata vlerësoi se përgjigjja që kanë dhënë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për pretendimin e kërkueses se paraqitja e padisë civile kushtëzohej nga vendimi penal i formës së prerë, është e plotë dhe e qartë, sepse analizon se konkurrimi i përgjegjësisë penale për autorin, nuk e pengonte atë në kërkimin e shpërblimit të dëmit në rrugë civile.

Gjykata vërejti se Gjykata e Lartë në analizë të vendimmarrjeve të këtyre gjykatave, duke bërë të vetin arsyetimin dhe analizën e tyre, me arsyetim të kufizuar *de plano*, ka vlerësuar se në rekursin e kërkueses nuk parashtroheshin asnjë nga shkaqet për të cilat ligjvënësi ka parashikuar ushtrimin e kompetencës së saj si gjykatë ligji.

Në këtë linjë, Gjykata çmoi se arsyetimi i Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe jurisprudencën kushtetuese, për rrjedhojë,

(*vijon në faqen 39)*

Gjykata e Lartë në analizë të vendimmarrjeve të këtyre gjykatave, duke bërë të vetin arsyetimin dhe analizën e tyre, me arsyetim të kufizuar de plano, ka vlerësuar se në rekursin e kërkueses nuk parashtroheshin asnjë nga shkaqet për të cilat ligjvënësi ka parashikuar ushtrimin e kompetencës së saj si gjykatë ligji.

Arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë nuk bie në kundërshtim me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, për sa kohë ai shpreh, në thelb, arsyet mbi të cilat Kolegji Civil ka vendosur mospranimin e rekursit gjatë shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit.

pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk është i bazuar, ndaj kërkesa rrëzohet.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (dy gjyqtarë janë shprehur me mendim pakice, kundër).

Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

Jak Dobrozi, Manushe Dobrozi, Eglantina Lleshi (Dobrozi), Gëzim Dobrozi, Ilir Dobrozi

Ligji i zbatueshëm në mosmarrëveshjen me objekt pavlefshmërinë/ shfuqizimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi

Vendimi nr. 76, datë 18.06.2026

FJALË KYÇE

AMTP/ Verifikim i titujve/ Pavlefshmëri/ Ligji nr. 20/2020/ Njësim i praktikës gjyqësore/ Heqje dorë nga e drejta e padisë

Faktet

Kërkuesi, Jak Dobrozi, në vitin 1996, është trajtuar me tokë "arë" dhe është pajisur me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP), në zbatim të ligjit 7501/1991. Në zbatim të ligjit 9948/2008, dhe me kërkesë të subjektit të interesuar Gj.M., Komisioni Vendor pranë Prefektit të qarkut Lezhë ka verifikuar vlefshmërinë e këtij titulli pronësie dhe, pas hetimit administrativ, e ka shfuqizuar atë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me padi të Prefektit të qarkut Lezhë, ka vendosur shfuqizimin tërësisht të AMTP-së dhe kthimin e tokës në pronësi të shtetit duke arsyetuar se kërkuesi nuk mund të përfitonte tokë bujqësore në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore të zbatueshme. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata Administrative e Apelit, ka vendosur rrëzimin e padisë së Prefektit të qarkut Lezhë, duke konfirmuar se krijimi i AMTP-së është bërë në përputhje me kërkesat e VKM-së 255/1991, "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore".

Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs subjektet e interesuara Gj.M., Avokatura e Shtetit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK). Përpara shqyrtimit të rekursit, subjekti i interesuar Gj.M. ka hequr dorë nga rekursi. Gjykata e Lartë, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se, vendimi i gjykatës së shkallës së parë është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit material mbi rrethanat konkrete të çështjes në gjykim. Në vijim, kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Gjykata e Lartë duhej të arsyetonte në mënyrë të posaçme për zbatimin e ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe veçanërisht në lidhje me mënyrën sesi zbatoheshin dispozitat e këtij ligji për heqjen dorë nga paditë e ngritura nga prefektët para hyrjes në fuqi të tij, me objekt pavlefshmërinë/ shfuqizimin e AMTP-ve.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor - Gjykata vërejti se Gjykata e Lartë e ka gjetur të përligjur interpretimin ligjor të gjykatës së shkallës së parë se për të përfituar tokë bujqësore duhet që subjekti të këtë qenë anëtar i kooperativës bujqësore dhe banor i saj ose qoftë dhe vetëm banor i fshatit sipas gjendjes civile në datën 01.08.1991, si dhe konstatimin prej saj të faktit se kërkuesi nuk ka qenë anëtar i Ndërmarrjes Bujqësore (NB) Gjorm dhe as banor i këtij fshati në datën 01.08.1991, por banor i lagjes nr. 6, qyteti Laç. Për pasojë, Gjykata vlerësoi se ky komponent i pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

Lidhur me argumentin se Gjykata e Lartë duhet të kishte pushuar gjykimin, pasi ai nuk duhet të vazhdonte në bazë të nenit 68, paragrafi 5, të ligjit 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilit ASHK-ja duhet të hiqte dorë nga gjykimet në proces të vëna në lëvizje nga prefektët përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me objekt pavlefshmërinë ose shfuqizimin e AMTP-ve, Gjykata konstatoi se, në rastin konkret, rekurset ishin paraqitur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 20/2020.

Po kështu, Gjykata konstatoi se rreth 2 muaj përpara marrjes së vendimit objekt kundërshtimi, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka marrë vendim të ndërmjetëm për njësimin e praktikës gjyqësore në këtë fushë, ndërsa disa muaj pas

(*vijon në faqen 41)*



vendimmarrjes për kërkuesin ka nxjerrë vendim me rregull njësues.

Në këto kushte, Gjykata çmoi se Gjykata e Lartë ka identifikuar ligjin nr. 9948/2008 si ligjin e zbatueshëm dhe nuk ka dhënë një përgjigje në lidhje me vazhdimin e gjykimit pranë kësaj gjykate në kushtet kur ligji nr. 20/2020, kishte përcaktuar se për të gjitha paditë e ngritura nga prefekti, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji me objekt pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP-ve, pavarësisht se në cilën shkallë gjykimi ndodhen, ASHK-ja detyrohet të heqë dorë nga e drejta e padisë.

Gjykata çmoi se vendimi i kundërshtuar nga kërkuesit nuk plotëson mjaftueshëm kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për ofrimin e garancive për proces të rregullt ligjor në aspektin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ndaj pretendimet e tyre për cenimin e këtij komponenti të kërkesës janë të bazuara.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës.

E drejta e aksesit e lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

Fondacioni Shqiptaro – Amerikan "Harry T. Fultz"

Pavlefshmëria absolute e pjesshme e VKM-së nr. 207/2000, për efekt të mbivendosjes së titujve të pronësisë

Vendimi nr. 77, datë 23.06.2026

FJALË KYÇE

Fondacion/ Kontribut shtetëror/ ASHK/ KKKP/ AKKP/ Trashëgimtarë/ Bashkëpronësi mbi truallin/ VKM-ja 207/2000/ Tejkalim kompetencash/ Këshilli i Ministrave/ Shfuqizim vendimi/ Mbivendosje titujsh pronësie/ Pavlefshmëri absolute e pjesshme e VKM-së/ Masë kufizimi mbi pasurinë e paluajtshme/ Pezullim gjykimi/ Regjistrim pasurie

Në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime:

***Sipas njërit qëndrim*, Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur detyrimin kushtetues për t'u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve thelbësore të rekursit. Mungesa e arsyetimit, si për çështjen e formimit të rregullt të ndërgjyqësisë dhe ndikimit të saj në të drejtat procedurale të kërkuesit, ashtu edhe për kërkesën për pezullimin e gjykimit administrativ deri në përfundimin e mosmarrëveshjes civile, ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë në aspektin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.**

Faktet

Subjekti i interesuar G.B., trashëgimtar i të ndjerit O.B., është bashkëpronar në truallin me sipërfaqe 1804 m², në Tiranë, të kthyer fizikisht me vendimin nr. 157/1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Tiranë dhe të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Tiranë.

Me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 207/2000, kjo sipërfaqe është përfshirë në pasuritë e dhëna si kontribut shtetëror për kërkuesin, Fondacionin "Harry T. Fultz". Ndërkohë, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), me vendimin nr. 160/2009, shfuqizoi vendimin nr. 157/1995, por pas kundërshtimit, akti u shpall absolutisht i pavlefshëm nga gjykatat e faktit në vitin 2012. Pas regjistrimit reciprok të titullit të pronësisë mbi truallin (në vitin 2013, nga ana e kërkuesit dhe në vitin 2014, nga ana e subjektit të interesuar), ZVRPP-ja Tiranë, urdhëroi vendosjen e masës së kufizimit për shkak të mbivendosjes së titujve.

Në vitin 2019, subjekti i interesuar i është drejtuar gjykatës me padi për konstatimin si pjesërisht absolutisht të pavlefshme të VKM-së nr. 207/2000, për pjesën që ka cenuar pasurinë truall me sipërfaqe 1804 m² të bashkëpronarëve të familjes B., si dhe detyrimin e ZVRPP-së Tiranë, të heqë masën e kufizimit në pasurinë e paditësit dhe të fshijë nga regjistri hipotekar çdo regjistrim tjetër që rrjedh nga VKM-ja. Si palë e paditur në gjykim është thirrur Këshilli i Ministrave dhe Agjencia e Shtetërore e Kadastrës (ASHK), kurse si person i tretë kërkuesi, Fondacioni. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, vendosi rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova, duke vlerësuar se Këshilli i Ministrave nuk kishte tejkaluar kompetencat në nxjerrjen e VKM-së nr. 207/2000. Lidhur me pretendimet për vlefshmërinë e titujve të pronësisë, ajo gjykatë vlerësoi se nuk ishin objekt i gjykimit dhe palët mund t`i drejtoheshin gjykatës civile. Vendimi u ankimua nga paditësi.

Gjykata Administrative e Apelit, in primis rrëzoi kërkesën e Fondacionit, i cili në cilësinë e personit të tretë, kërkoi pezullimin e gjykimit të çështjes deri në përfundimin të çështjes civile mbi disponimin e titullit të pronësisë së truallit të kontestuar, me arsyetimin se pavarësisht lidhjes midis dy gjykimeve, vlerësimi nëse VKM-ja nr. 207/2000, ishte ose jo një akt administrativ pjesërisht absolutisht i pavlefshëm nuk varej nga përfundimi i gjykimit civil të vënë në lëvizje nga personi i tretë (Fondacioni). Ajo gjykatë e pranoi padinë dhe konstatoi pavlefshmërinë absolute të pjesshme të VKM-së, duke urdhëruar ASHK-në për heqjen e kufizimit dhe regjistrimin e pasurisë sipas vendimit nr. 157/1995. Kundër vendimit ka paraqitur rekurs kërkuesi dhe Avokatura e Shtetit, por Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij. Në vijim, kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Vlerësimi i Gjykatës

Për legjitimimin e kërkuesit, në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive - Mbi pretendimin e cenimit *të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe të parimit të barazisë në të drejta*, si pasojë e mosformimit të

(*vijon në faqen 43)*

***Sipas qëndrimit tjetër*, kërkuesi ka ushtruar lirisht të drejtën e tij të rekursit në Gjykatën e Lartë, ku ka parashtruar pretendimet e tij për vendimin e gjykatës së apelit.**

Shkaqet e rekursit të parashtruara nga kërkuesi përpara asaj gjykate, qoftë në formë a në substancë, nuk janë të tilla që të bëjnë të cenueshëm procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatën e apelit, për rrjedhojë duke lënë në fuqi interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga Gjykata Administrative e Apelit. Ky arsyetim nuk rezulton të jetë alogjik ose haptazi i paarsyeshëm, pra që të vërë në dyshim vetë thelbin e së drejtës për gjykim të drejtë.

drejtë të ndërgjyqësisë (për shkak se kërkuesi, duke u thirrur në gjykim në cilësinë e personit të tretë, ka pasur mjete procedurale jo të barabarta dhe të kufizuara në krahasim me palën tjetër), në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje në lidhje me të, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

-*Sipas njërit qëndrim,* u vlerësua se kërkuesi nuk e ka ngritur më parë në Gjykatën e Lartë, në formë ose substancë, pretendimin për mosformimin e drejtë të ndërgjyqësisë në procesin gjyqësor, ose që të mos ketë pasur mundësinë të ushtrojë të drejtat e tij apo të parashtrojë pretendimet e tij gjatë atij gjykimi. Për rrjedhojë, sipas këtij qëndrimi, kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

-*Sipas qëndrimit tjetër*, ndonëse ky pretendim nuk është formuluar shprehimisht në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, ai rezulton të jetë parashtruar në substancë, si argument i lidhur ngushtësisht me procesin civil për kundërshtimin e vendimit nr. 157/1995, të KKKP-së, Tiranë, i cili është ngritur si shkak edhe në rekurs. Për rrjedhojë, kërkuesi ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion të tij.

Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit - Pas shqyrtimit të këtij pretendimi, në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje në lidhje me (pa)bazueshmërinë e tij në themel, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

-*Sipas njërit qëndrim*, pretendimi i kërkuesit është i bazuar, pasi së pari, Gjykata e Lartë nuk ka dhënë një përgjigje të arsyetuar ndaj pretendimit, të parashtruar në substancë në rekurs, që lidhej me formimin e rregullt të ndërgjyqësisë dhe pasojat që kjo çështje kishte mbi pozitën procedurale të kërkuesit, veçanërisht në lidhje me mundësinë e tij për të marrë pjesë efektivisht në proces dhe për të mbrojtur të drejtat e pretenduara. Së dyti, ajo nuk i është përgjigjur as pretendimit për pezullimin e gjykimit administrativ deri në përfundimin e procesit civil, në të cilin po shqyrtohej vlefshmëria e titullit të pronësisë mbi truallin. Ky pretendim kishte rëndësi thelbësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, pasi vetë VKM-ja e kundërshtuar kishte disponuar mbi të drejtën e pronësisë mbi atë truall, duke u mbështetur në dispozitat e Kodit Civil që rregullojnë marrëdhëniet e pronësisë. Në këto kushte, Gjykata e Lartë duhej të vlerësonte nëse vijimi i gjykimit administrativ përpara përfundimit të procesit civil ishte i pajtueshëm me kërkesat e një mbrojtjeje gjyqësore efektive dhe me nevojën për të shmangur vendime potencialisht kontradiktore.

-*Sipas qëndrimit tjetër*, kërkuesi ka ushtruar lirisht të drejtën e tij të rekursit në Gjykatën e Lartë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, edhe pse me një arsyetim të kufizuar, ka vlerësuar se shkaqet e rekursit të parashtruara nga kërkuesi, në formë e në substancë, nuk janë të tilla që të bëjnë të cenueshëm procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatën e apelit, duke lënë në fuqi interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga Gjykata Administrative e Apelit.

Ky arsyetim nuk rezulton të jetë alogjik ose haptazi i paarsyeshëm, pra që të vërë në dyshim vetë thelbin e së drejtës për gjykim të drejtë. Vetëm fakti se Kolegji Administrativ ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit nuk është i mjaftueshëm, në këndvështrimin kushtetues, për të vënë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor. Për këto arsye, pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, është i pabazuar ndaj kërkesa rrëzohet.

Vendimmarrja

Gjykata, në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të saj, vendosi, rrëzimin e kërkesës.

E drejta e jetës private - Mbrojtja e të dhënave personale - E drejta e fshehtësisë së korrespondencës dhe e integritetit vetjak në aspektin procedural - Standardi i arsyetimit të vendimit - E drejta për kontroll gjyqësor efektiv

FJALË KYÇE

Kontroll i ambienteve/ Prova dokumentare dhe elektronike/ Kontroll vetjak/ Sekuestrim i telefonit/ Autorizim gjyqësor

Gjykata e Lartë duhet të mbajë parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, standardet e përcaktuara në jurisprudencën kushtetuese për ekzistencën dhe individualizimin e shkaqeve konkrete që mund të përligjin kontrollin vetjak dhe sekuestrimin, për dallimin ndërmjet veprimeve teknike të sigurimit të integritetit të provës dhe veprimeve hetimore të kërkimit e përpunimit të të dhënave, si dhe për përcaktimin e objektit dhe të shtrirjes së aksesit, kufizimin e përpunimit në minimumin e domosdoshëm dhe garantimin e një procedure për ndarjen dhe trajtimin e të dhënave që nuk lidhen me hetimin ose që gëzojnë mbrojtje të posaçme.

Vladimir Vladimirov

Kontrolli gjyqësor mbi ligjshmërinë e kontrollit vetjak dhe sekuestrimit të telefonit

Vendimi nr. 78, datë 29.06.2026

Faktet

Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal për veprat penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve që ushtrojnë funksione publike”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale e veprimtarisë kriminale”, të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal” pasi kishte dyshime të arsyeshme se procedurat e prokurimit publik me objekt furnizimin e spitaleve me oksigjen të lëngshëm dhe të gaztë kanë qenë të paracaktuara dhe në marrëveshje të fshehtë ndërmjet disa shoqërive me autoritetin kontraktor, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në kuadër të hetimeve të këtij procedimi penal, fillimisht Prokuroria e Posaçme i ka paraqitur kërkesë gjykatës për kontrollin personal të 12 shtetasve, të ndryshëm nga kërkuesi. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO-ja e Shkallës së Parë) ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lejimin e kontrollit personal të këtyre shtetasve. Njëkohësisht Prokuroria e Posaçme i është drejtuar gjykatës me kërkesë edhe për kontrollin e banesave, ambienteve dhe zyrave të disa individëve dhe shoqërive të përfshira në hetim, ndër të cilat edhe të shoqërisë në të cilën ishte administrator kërkuesi. Këto kërkesa janë pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë me të cilin është lejuar, ndër të tjera, kontrolli i zyrave të selisë së shoqërisë “M.A.” sh.p.k. Gjatë ekzekutimit të këtij vendimi oficerët e Policisë Gjyqësore kanë kryer edhe kontrollin personal të kërkuesit, i cili ndodhej në këto ambiente, dhe i kanë sekuestruar telefonin celular me dy karta SIM. Procesverbali i kontrollit është nënshkruar nga kërkuesi në prani të një personi të besuar, ndërsa sekuestrimi është arsyetuar me rrezikun e ndryshimit ose humbjes së sendit.

Kërkuesi ka kundërshtuar ligjshmërinë e sekuestrimit dhe ka kërkuar kthimin e telefonit celular. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, ka çmuar se ekzistonte dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprave penale dhe se kontrolli synonte gjetjen e gjurmëve dhe sekuestrimin e provave materiale që mund t’i shërbenin hetimit, përfshirë pajisjet elektronike. Kërkuesi ndodhej në ambientet ku po kryhej kontrolli dhe atij i ishte sekuestruar një send që përfshihej në objektin e kontrollit të autorizuar për ambientet.

Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO-ja e Apelit), e cila ka vlerësuar të ligjshëm sekuestrimin e telefonit celular dhe vendimin e Prokurorisë së Posaçme për vleftësimin e tij. Ndërsa, Gjykata e Lartë, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjërin prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Në vijim, kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Vlerësimi i Gjykatës

- Për pretendimin e cenimit të së drejtës për jetë private në drejtim të mbrojtjes të të dhënave personale, fshehtësisë së korrespondencës dhe integritetit vetjak - në aspektin procedural.

(*vijon në faqen 45)*

Po kështu, ajo duhet të ushtrojë një kontroll gjyqësor efektiv ex post factum të ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të këtyre ndërhyrjeve.

- Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit dhe të së drejtës për një kontroll gjyqësor efektiv - Gjykata vërejti se kontrolli vetjak ka qenë veprimi procedural përmes të cilit është gjetur telefoni celular, ndërsa sekuestrimi ka përbërë pasojën e drejtpërdrejtë të këtij veprimi. Për këtë arsye, ligjshmëria e sekuestrimit nuk mund të shqyrtohej në mënyrë të shkëputur nga ligjshmëria e kontrollit vetjak që e kishte paraprirë.

Gjykatat e zakonshme duhej të verifikonin, mbi bazën e pretendimeve dhe akteve të paraqitura, natyrën e veprimeve të kryera ose të synuara mbi të dhënat e telefonit dhe nëse ato kufizoheshin në sigurimin teknik të integritetit të provës ose shtriheshin në kërkimin, analizën, përzgjedhjen dhe marrjen e të dhënave me rëndësi për hetimin. Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore objekt kundërshtimi nuk rezulton që gjykatat e zakonshme të kenë analizuar në mënyrë të arsyetuar nëse kontrolli vetjak dhe sekuestrimi i telefonit celular, si dhe qëllimi i këtij sekuestrimi për të mundësuar aksesimin në përmbajtjen e pajisjes, përmbushnin kriteret e nenit 17 të Kushtetutës.

Gjykata vërejti se, ndonëse gjykatat e kanë identifikuar qëllimin e masave, duke e lidhur atë me sigurimin e provave dhe mbarëvajtjen e procesit penal, ato nuk i kanë analizuar në mënyrë të mjaftueshme kriteret e ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të secilës ndërhyrje. Gjykatat nuk kanë shqyrtuar nëse aksesimi i synuar ose eventualisht i realizuar i përmbajtjes së telefonit ishte i kufizuar në të dhënat me rëndësi për hetimin dhe nëse shoqërohej me garanci të mjaftueshme kundër një kërkimi ose përpunimi të pakufizuar, përfshirë ndarjen dhe trajtimin e të dhënave që nuk kishin lidhje me hetimin.

Gjithashtu Gjykata e Lartë, në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë ligji, duhej t'u jepte përgjigje pretendimeve të kërkuesit me natyrë kushtetuese. Në veçanti, ajo duhej të vlerësonte nëse gjykatat më të ulëta kishin identifikuar rrethanat konkrete që mund të justifikonin kontrollin personal të kërkuesit dhe sekuestrimin e telefonit, si dhe nëse kishin kontrolluar ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e ndërhyrjes së mëtejshme në të dhënat personale dhe korrespondencën përmes aksesimit të synuar në përmbajtjen e tij, shtrirjen e veprimeve të synuara ose të realizuara mbi të dhënat dhe garancitë për të dhënat që nuk kishin lidhje me hetimin. Gjykata e Lartë është mjaftuar me konstatimin se gjykatat më të ulëta kishin arsyetuar në mënyrë logjike dhe se neni 205 i KPP-së lejon kontrollin e personave të pranishëm.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin pjesërisht të kërkesës.

Parimi i sigurisë juridike - Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

Ilirian Cani

Moskompensimi i drejtë i pronës së shpronësuar

Vendimi nr. 79, datë 30.06.2026

FJALË KYÇE

Trashëgimtarë ligjorë të subjektit të shpronësuar/ Moszbatim i tejzgjatur i vendimit të KKKP-së/

Vlerësim financiar i pronës së njohur për kompensim nga ATP-ja/ Ligji nr. 133/2015; VKM-ja nr. 223/2016, dhe VKM-ja nr. 89/2016/ Mjet juridik efektiv

Mospranimi nga Gjykata e Lartë e rekursit të kërkuesit, duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin *de plano* të çështjes dhe me arsyetimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese për të drejtën e pronës, si dhe mosrespektimi i fuqisë detyruese të jurisprudencës kushtetuese dhe asaj ndërkombëtare, ka vënë në dyshim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore kushtetuese.

Faktet

Kërkuesi është një nga trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar, të cilit me vendimin nr. 1278/1996, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), i është njohur pronësia mbi një sipërfaqe 130.000 m², si dhe e drejta për kompensim sipas ligjit. Ndërkohë që kërkuesi i ishte drejtuar GJEDNJ-së lidhur me moszbatimin e tejzgjatur të vendimit të KKKP-së, Agjencia e Trajtimit të Pronës (ATP) ka publikuar vlerësimin e parë financiar të vendimit të KKKP-së. Kërkuesi, duke mos qenë dakord me këtë vlerësim, e ka kundërshtuar atë në gjykatën e apelit, por ndërkohë që çështja ishte në shqyrtim në atë gjykatë, ATP-ja ka publikuar rivlerësimin financiar të vendimit nr. 1278/1996, të KKKP-së, duke dhënë të njëjtën vlerë. Edhe ky rivlerësim është kundërshtuar nga kërkuesi në gjykatën e apelit dhe gjykata ka vendosur bashkimin e padive në një të vetme. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata e apelit ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se, në kohën e shpronësimit kjo pronë ka qenë e zërit kadastral "kullotë - livadh" dhe jo "truall" dhe se, metoda e vlerësimit ishte në përputhje me Kushtetutën dhe me vendimin nr. 1/2017, të Gjykatës. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

Në kohën kur çështja ishte për gjykim në Gjykatën e Lartë, GJEDNJ-ja, ka vendosur mospranimin e kërkesës së kërkuesit, me arsyetimin se mjeti juridik i prezantuar nga ligji për pronat i vitit 2015 ishte efektiv.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 77/2022, ATP-ja ka kryer një vlerësim të dytë të vendimit nr. 1278/1996, të cilin kërkuesi e ka kundërshtuar sërish në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat kanë vendosur pezullimin e gjykimit deri në përfundimin e procesit gjyqësor të vlerësimit të parë. Në vijim kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Vlerësimi i Gjykatës

Për legjitimimin e kërkuesit - Gjykata konstatoi se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të dyja shkallët e gjykimit dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

Për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit - Gjykata vërejti se kërkuesi në procesin ligjor të zhvilluar nga ATP-ja dhe në vijim në procesin gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat, që kanë vendosur për vlerësimin/ rivlerësimin e parë financiar të pronës, ka pritur që kompensimi i saj të bëhej sipas zërit kadastral të llojit "truall" në kohën e shpronësimit, të njohur edhe me vendimin nr.1278/1996, të KKKP-së, ndërkohë që ATP-ja në vitin 2018, e ka vlerësuar pasurinë duke e kategorizuar atë në zërin kadastral "kullotë – livadh".

Gjykata Administrative e Apelit në vendimmarrjen e saj i është referuar të dhënave arsyetuese të ATP-së, por pa marrë parasysh përcaktimin e zërit kadastral sipas vendimit nr. 1278/1996, të KKKP-së, ndërkohë që ka pretenduar që barrën e provës për përcaktimin e zërit kadastral të pronës e ka kërkuesi. Gjykata e Lartë, megjithëse ndodhej përpara pretendimeve me natyrë kushtetuese, në lidhje me të drejtën

(*vijon në faqen 47)*



e pronës të kërkuesit për shpërblim të drejtë sipas zërit kadastral "truall" të përcaktuar me vendimin e formës së prerë nr. 1278/1996, të KKKP-së, Tiranë, në ushtrim të funksionit të saj dhe të parimit të subsidiaritetit, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur për pretendimet e ngritura në rekurs. Në rastin e kërkuesit nuk është analizuar nëse vlerësimi i pronës ka respektuar standardin minimal "10% për diferencën në vlerësim midis zërit kadastral të sotëm dhe atij të kohës së shpronësimit", në kuptim të neneve 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, pasi në përmbajtjen e vendimit të Gjykatës së Lartë nuk janë marrë në konsideratë vendimet detyruese të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së. Kjo situatë është rrjedhojë e disa faktorëve, duke filluar me mosveprimin e Kuvendit për plotësimin e detyrimit të caktuar me vendimin nr. 4, datë 15.02.2021, të kësaj Gjykate, me ekzistencën për një kohë të konsiderueshme të boshllëkut ligjor, me mosrespektimin e fuqisë detyruese të jurisprudencës kushtetuese dhe ndërkombëtare, për të përfunduar me arsyetimin e gjykatave, të cilat, në çdo rast, duhet të luajnë rolin e tyre subsidiar për respektimin e të drejtave themelore, pa u shmangur nga ky rol edhe në rastet e boshllëkut ligjor.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin pjesërisht të kërkesës (tre gjyqtarë u shprehën me mendim pakice).

E drejta e aksesit - Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

Pranvera Dashi dhe Denis Dashi

Ligji i zbatueshëm në mosmarrëveshjen me objekt pavlefshmërinë/ shfuqizimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi

Vendimi nr. 80, datë 30.06.2026

FJALË KYÇE

Tokë bujqësore/ Ristrukturim i ndërmarrjeve bujqësore/ Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi/ Ligji nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"/ Paditë e ngritura nga Prefekti / Vendimi njësues i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

Faktet

Kërkuesit kanë përfituar tokë pa pagesë nëpërmjet Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) së vitit 1999, e cila është shfuqizuar më pas nga Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefekturës së Qarkut Tiranë. Në bazë të këtij vendimi të fundit, prefekti i qarkut Tiranë i është drejtuar gjykatës duke kërkuar deklarimin e pavlefshmërisë së plotë të AMTP-së.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e padisë, pasi ka vlerësuar se në rastin konkret gjen zbatim Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 452, datë 17.10.1992, "Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore", e ndryshuar, dhe se, për rrjedhojë, familja bujqësore e kërkueses Pranvera Dashi (mbesë e të ndjerit Shaqir P.), përmbush kriteret e përcaktuara në të për të përftuar tokë bujqësore. Ajo gjykatë ka konstatuar se toka që është dorëzuar për krijimin e ish-kooperativës është e zërit kadastral "tokë bujqësore" dhe jo "kullotë" dhe se prona e ish-pronarit është sekuestruar në vitin 1946. Në të kundërt, gjykata e apelit ka vlerësuar se ligji i zbatueshëm është ligji nr. 9948, datë 07.07.2008, "Për vlefshmërinë e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", i ndryshuar. Gjithashtu, edhe lëshimi i AMTP-së nuk është i përligjur sipas saj, pasi kërkuesja ose anëtarë të trungut të saj familjar nuk kanë qenë punonjës të ish-ndërmarrjes bujqësore dhe as banorë të fshatit dhe as kanë pasur cilësinë e dorëzuesit të tokës bujqësore, për t'u trajtuar me tokë bujqësore në përdorim e më pas në pronësi, duke vlerësuar se toka është marrë prej kërkuesve në kundërshtim me ligjin. Ky vendim është lënë në fuqi nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili ka arsyetuar se edhe pretendimet eventuale mbi pronën nuk rregulloheshin nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën", por nga legjislacioni përkatës për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve. Në vijim, kërkuesit iu drejtuan Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, si dhe të çmuarjes së provave për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese të individit për proces të rregullt ligjor.

Ndonëse çështja juridike ishte shtruar për njësim përpara se të vendosej rekursi i kërkuesve, Gjykata e Lartë vendosi çështjen pa pritur përcaktimin e rregullit njësues, i cili u miratua vetëm pak ditë më pas.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor - Gjykata vlerësoi se Gjykata e Lartë, në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë ligji, kishte detyrimin të verifikonte dhe të shprehej në mënyrë të arsyetuar nëse ligji nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" ishte i zbatueshëm në çështjen konkrete të kërkuesve. Ky detyrim buronte jo vetëm nga fakti se ligji kishte hyrë në fuqi gjatë kohës që çështja ndodhej për shqyrtim në atë gjykatë dhe përmbante dispozita kalimtare që shtriheshin edhe mbi proceset në vijim, por edhe nga fakti se vetë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë kishte shtruar për njësim pikërisht çështjen juridike që lidhej me interpretimin dhe zbatimin e këtyre dispozitave.

Në këto rrethana, mosmarrja në konsideratë e këtij ligji dhe mungesa e çdo arsyetimi në lidhje me zbatueshmërinë e tij në çështjen konkrete, pavarësisht se kërkuesit e kishin ngritur këtë çështje në parashtrimet e tyre, nuk përbën thjesht një çështje të interpretimit të ligjit material, e cila, si rregull, mbetet jashtë juridiksionit kushtetues.

(*vijon në faqen 49)*

Në kushtet kur vendimi njësues kishte për objekt pikërisht interpretimin e dispozitave kalimtare që ishin të zbatueshme në procese si ai i kërkuesve, kjo mënyrë procedimi e Gjykatës së Lartë duket se ka cenuar edhe pritshmëritë e ligjshme të tyre që çështja të shqyrtohej mbi bazën e një interpretimi të njëjtë dhe uniform të ligjit.

Ajo përbën një gabim ligjor, pra një mungesë arsyetimi për një çështje thelbësore dhe potencialisht përcaktuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Gjykata thekson se verifikimi nga ana e Gjykatës së Lartë i heqjes dorë nga prefekti për këto çështje, merr rëndësi nga pikëpamja kushtetuese për individin, pasi prima facie lidhet me të drejtën e pronës private, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. Një qasje e tillë e Gjykatës së Lartë nuk përmbush standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe nuk u jep kërkuesve një përgjigje gjyqësore efektive për një pretendim me rëndësi vendimtare për çështjen e tyre.

Gjykata vërejti se, ndonëse çështja juridike ishte shtruar për njësim përpara se të vendosej rekursi i kërkuesve, Gjykata e Lartë vendosi çështjen pa pritur përcaktimin e rregullit njësues, i cili u miratua pak ditë më pas. Në kushtet kur vendimi njësues kishte për objekt pikërisht interpretimin e dispozitave kalimtare që ishin të zbatueshme në procese si ai i kërkuesve, kjo mënyrë procedimi e Gjykatës së Lartë duket se ka cenuar edhe pritshmëritë e ligjshme të tyre që çështja të shqyrtohej mbi bazën e një interpretimi të njëjtë dhe uniform të ligjit.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e pjesshëm të kërkesës.

Liria personale – Parimi i proporcionalitetit të ndërhyrjes – Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

Evis Berberi

Zëvendësimi i masës së kufizimit të lirisë personale "Arrest në burg"

Vendimi nr. 81, datë 02.07.2026

FJALË KYÇE

Drejtor i ARRSH-së/ Përfitime të parregullta monetare/ Detyrë publike/ Prokurim publik/ kuota të shoqërisë/ "Arrest në burg"/ Përshtatshmëri e masës/ Zëvendësim i masës së sigurimit

Faktet

Në vitin 2023, Prokuroria e Posaçme regjistroi procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal (KP) e në vijim, regjistroi edhe veprat penale të parashikuara nga nenet 244 e 25, 259 dhe 287/2 të KP-së. Për këto dy të fundit u regjistrua edhe emri i kërkuesit mbi dyshimin, se në cilësinë e ish-drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Eficiencës së Energjisë (AFE) e më pas në atë të Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH), ka pranuar dhe marrë në mënyrë të tërthortë nga shoqëria "N." e cila ka fituar procedura të prokurimit publik të zhvilluara nga autoritetet publike kontraktore ku kërkuesi ka qenë titullar, përfitime të parregullta monetare nëpërmjet shoqërisë "D." të zotëruar prej tij indirekt e të investuara më pas për blerjen e pasurive të paluajtshme në emër të shoqërisë "D.". Në datën 13.03.2024, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO-ja e shkallës së parë) caktoi ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal "Arrest në burg", e cila u ekzekutua po në atë datë. Me vendimin e datës 16.03.2024, GJKKO-ja e shkallës së parë vendosi vazhdimin e zbatimit të kësaj mase, e cila u miratua nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO-ja e apelit), me vendimin e datës 25.04.2024, kurse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 17.10.2024, vendosi mospranimin e rekursit të kërkuesit. Me vendimin nr. 40, datë 26.03.2026, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën e kërkuesit për kundërshtimin e këtyre vendimeve gjyqësore. Në datën 30.07.2024, kërkuesi i kërkoi GJKKO-së së shkallës së parë dhënie informacioni në lidhje me hetimet, si dhe zëvendësimin e masës së sigurimit dhe po në atë datë GJKKO-ja e shkallës së parë vendosi vazhdimin e zbatimit të masës, vendim ky që u miratua nga GJKKO-ja e Apelit në datën 10.10.2024, kurse Gjykata e Lartë me vendimin e datës 30.01.2025, vendosi mospranimin e rekursit të kërkuesit. Në vijim kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual.

Gjykatat e zakonshme kanë shqyrtuar dhe vlerësuar se edhe pse kanë kaluar 4 muaj nga caktimi i masës së sigurimit "Arrest në burg", nevojat e sigurimit vazhdojnë të jenë reale dhe aktuale. Kjo analizë është zhvilluar në mënyrë të individualizuar prej atyre gjykatave, duke iu përgjigjur fakteve dhe rrethanave specifike të rastit konkret, pa e zhvendosur barrën te personi i paraburgosur (kërkuesi) për të provuar arsyet që justifikojnë lirimin e tij.

Vlerësimi i Gjykatës

Për cenimin e lirisë personale në raport me parimin e proporcionalitetit lidhur me standardin e arsyetimit – Gjykata konstatoi se si shkak për zëvendësimin e masës kërkuesi ka parashtruar rrethanat familjare dhe gjendjen shëndetësore të bashkëshortes që e bën të pamundur për të ushtruar të drejtat dhe detyrat ndaj fëmijëve. Në lidhje me këtë GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se nuk përfshihet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 230, pika 2, i Kodit të Procedurës Penale (KPP), pasi situata e veçantë familjare dhe situata e referuar nga kërkuesi është e paaftë për të influencuar rëndësinë e nevojave të sigurimit.

Sipas arsyetimit të GJKKO-së së Apelit, sipas pikës 2 të nenit 230 të KPP-së, vazhdimësia e saj qëndron në raport me gjendjen shëndetësore veçanërisht të rëndë të vet personit i cili duhet t'i nënshtrohet masës së sigurimit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se nuk rezulton që gjendja shëndetësore e bashkëshortes së kërkuesit të jetë veçanërisht e rëndë ose që ajo është në pamundësi absolute për t'u kujdesur për fëmijët e mitur, si dhe ka vlerësuar të drejtë dhe të mjaftueshëm arsyetimin e gjykatave më të ulëta. Ai kolegj e ka vlerësuar të drejtë dhe të

(*vijon në faqen 51)*



mjaftueshëm arsyetimin e gjykatave më të ulëta sa i takon pretendimeve të kërkuesit për ekzistencën e shkaqeve që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provave apo se nuk ekziston rreziku i ikjes dhe i kryerjes së të njëjtës vepër penale ose më të rëndë, duke i vlerësuar në përputhje me parimin e përshtatshmërisë dhe të proporcionalitetit. Gjykatat në të gjitha shkallët e gjykimit kanë analizuar se dyshimi i arsyeshëm vijonte të ekzistonte, pasi kishte arsye të qarta, relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar vijimin e qëndrimit të kërkuesit nën masën e sigurimit "Arrest në shtëpi" në përputhje me rrethanat individuale të tij.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, rrëzimin e kërkesës.

DECISIONS OF THE CONSTITUTIONAL COURT OF THE REPUBLIC OF ALBANIA 1998-2011
VENDIME TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË 1993-2015
VENDIME TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË 1993-2015
VENDIME TË GJYKATËS KUSHTETUESE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË 2012
VENDIME TË PËRZGJEDHURA TË GJYKATËS KUSHTETUESE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË 1922-2022